

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

814-2

K94



BASHKIM KOZELI

# SINJALI I KUQ

814-L

K 94

BASHKIM KOZELI

R

# SINJALI I KUQ

Dramë



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

**Redaktor: Ramazan Vozga**  
**Kopertina nga Roland Karanxha**

Tirazhi 1 000 kopje    Format 70x100/32    Stash: 2204-72

---

Shtyp Drejtoria Qendrore Poligrafike  
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1974

## PERSONAZHET VEPRUESE:

ADMIRALI SHQIPTAR ..	
ARBENI .....	komandant i bazës së nën- detëseve
SKËNDERI .....	inxhinier i nëndetëses
AGIMI .....	marinar shqiptar, bocman
FATMIRI .....	marinar shqiptar
SUZANA .....	motra e Skënderit
VOLLKOVI .....	admiral sovjetik
NIKOLLAI .....	komandant i bazës së nën- detëseve
SERGEI .....	ish-komandant
BORISI .....	inxhinier i nëndetëses
BOCMANI .....	sovjetik
VOLLODJA .....	marinar sovjetik
NINA .....	gruaja e Nikollait
KULIKU .....	marinar sovjetik
OFICERË DHE DETARË SHQIPTARË DHE SOVJE- TIKË	

## PROLOGU

(Në paraskenë)

VOLLKOVI — Po ju ç'thoni, komandant Sergei? A janë në gjendje ekipazhet shqiptare të drejtojnë nëndetëset? Ti i dëgjove vartësit...

SERGEI — Shoku admiral, para se të vinit ju në mbledhje, vartësit më raportuan ndryshe. Ndërsa në diskutimet e tanishme po flasin ndryshe. Kjo është e pahijshme.

VOLLKOVI — Sergei, ti je disi i rrëmbyer. Komandanti duhet të ketë më shumë besim te vartësit.

SERGEI — Unë nuk mund të bindem me të kundërtën e argumenteve.

BORISI — Marr guximin të flas, në qoftë se do të më lejohet, shoku admiral...

VOLLKOVI — Po.

BORISI — Sergei është komandant i gjithë bazës. Por në lundrimin e sotëm ai s'kishte se si t'i vinte re të gjitha veprimet dhe një farë pasigurie nga ana e ekipazheve shqiptare.

SERGEI — Inxhinier Borisi (*U tregon shokëve bllokun e shënimeve*), e shikon çfarë raporti më ke ni dhënë? Këtu kam shënuar: «Shkëlqyeshëm». Ndërsa tani...

BORISI — Ndoshta na rrëmbeu dëshira e mirë

për t'ua dorëzuar shokëve shqiptarë sa më parë nën-  
detëset. Me sa duket kjo dëshirë na bëri të flisnim  
me entuziazëm në fillim të mbledhjes. Por, në qoftë  
se eprorët tanë kanë mendim se jemi nxituar, atëhe-  
rë, shokë, ne duhet të reflektojmë. Mbi të gjitha,  
jemi ushtarakë.

VOLLKOVI — (Shikon admiralin shqiptar) Si-  
gurisht që shoku admiral dhe unë, në këtë mbledhje,  
jemi më tepër dëgjues. Në fund të fundit vendosni  
ju, komandantët, ju, shoku Sergei. Vetëm të mos  
harrojmë që mjetet janë të ndërlikuara, detyrat të  
vështira dhe në këto çështje s'ka vend për senti-  
mentalizëm dhe gjaknxehtësi. A më kuptuat, Sergei?

SERGEI — Shoku admiral, nga të gjitha të dhë-  
nat del se, në stërvitjen e sotme, pala shqiptare bëri  
përpjekje serioze...

VOLLKOVI — Tjetër janë përpjekjet dhe tjetër  
rezultati. Më thoni, a pati të meta në stërvitje?

ARBENI — Me leje? Përse gjithë ky mosbesim,  
shoku Vollkov?! Doemos, ne patëm dhe ndonjë të  
metë, por pala jonë i asgjësoi objektet qysh me si-  
luret e para. A nuk është kështu, more shokë? Flisni!  
Ju na u hodhët në qafë dhe na puthët me gëzim.  
Përgëzuat marinarët tanë dhe u thatë: «Ju lumtë,  
djema! Ja, kështu duhet». Flisni hapur! Në qoftë  
se vërtet nuk e meritojmë t'i marrim në dorëzim  
nëndetëset, të paktën na e thoni troç, me kurajë,  
dhe jo...

VOLLKOVI — Më qetë, shokë, më qetë! Në  
asnjë mënyrë keqkuptime. Ne stërvitemi të dubluar  
nëpër postet luftarake si vëllezër të një arme. Dhe  
në qoftë se kërkesa bëhet e rreptë, kjo është për  
hir të çështjes që pala juaj të aftësohet sa më mirë.

ADMIRALI SHQIPTAR — Me një fjalë, ju,

shoku Vollkov, nuk jeni dakord që ekipazhet shqip-tare t'i drejtojnë vetë nëndetëset?

VOLLKOVI — Oh, jo, shoku admiral! T'ua lëmë atyre që kanë qenë në lundrim të vendosin për këtë gjë. Veç të mos harrojmë se këtej afër sillet flota amerikane...

ADMIRALI SHQIPTAR — Flota amerikane? Kjo flotë nuk ka ardhur tani, në qershor të 60-tës. Kjo ka kohë që vërtitet. Prandaj dhe po i bëjmë sytë katër.

VOLLKOVI — Ne kemi sinjalizime, që ka rrezik të...

ADMIRALI SHQIPTAR — Këtë sinjalizim morët sot nga Moska?

VOLLKOVI — Hëm! Sigurisht rreziku nuk duhet nënvleftësuar. (*Sergeit*) Kapiten Sergei, përse nuk flisni? Komandantit nuk i shkon hutimi.

SERGEI — Shoku admiral, kurrë nuk e kam pasur zakon ta bëj të bardhën të zezë. Për fjalë të nderit, sot kishe qejf të lundroje me ekipazhe të tilla. Çapajeva u treguan të gjithë, për fjalë të nderit!..

VOLLKOVI — Ç'është kjo: «Për fjalë të nderit, për fjalë të nderit?!» Me kë po flisni kështu, me dadon tuaj?!

SERGEI — Më falni, shoku admiral, por...

VOLLKOVI — Entuziazmoheni si të vegjlit dhe nuk çmoni detyrën e rëndësishme që ju është besuar. Të përgatitësh ekipazhe nëndetëseje, nuk është aq e lehtë, komandant Sergei. Mos harro se jemi përgjegjës përpara kampit të madh socialist, ndërsa ju... (*Sovjetikët dalin*).

ARBENI — Shoku admiral, ju betohem! Ne sot dolëm shkëlqyeshëm. Me silurin e parë. Kjo është më se e vërtetë, shoku admiral.

ADMIRALI SHQIPTAR — (*Mendueshëm*) Jo, ata nuk duhet të arrinin deri këtu.

## TABLOJA E PARË

(Skena: Baza lundruese e nëndetëseve. Mbrëmje. Poshtë, në bankinën ku është akostuar baza lundruese, bëjnë roje Fatmiri dhe Vullodja. Nga lart dëgjohen zëra, duartrokitje, gjallëri dhe muzikë vullëzimi.)

FATMIRI — Vovka!

VOLLODJA — . . . . .

FATMIRI — Vullodja!

VOLLODJA — Hë!

FATMIRI — Si e quajnë komandantin e ri?

VOLLODJA — Nikollai.

FATMIRI — Po pse e hoqën komandant Sergein që këtej?

VOLLODJA — Djalli e merr vesh. Me siguri i kanë dhënë ndonjë pozitë të madhe.

FATMIRI — Ashtu do të jetë, me siguri. Veçse, më ka ardhur keq që na la. Nuk e di si është ky i riu, po komandant si Sergei nuk bën më nëna. Vërtet jua mblidhte ca, por ishte shpirt njeriu.

VOLLODJA — Ee, sa janë të vegjël, ashtu duken. Por, kur hipin lart e u shtohen rrogat, ndryshojnë punët.

FATMIRI — Mos fol kot, Vullodja!

VOLLODJA — Mua më tregon ti? Fluturojnë fare! Edhe kryetari i kolkozit tonë, sa ishte pa pozitë, ankohej për ata të kryesisë. Por, tani që hipi



vetë... tokën më të majme ai, gjithë farefisnin nëpër zyra, etj. etj. . .

FATMIRI — Hë, mo, se ne, fshatarët, i vëmë re shumë këto gjëra. Jemi të lidhur me atë të shkretë të interes. Po nuk na e bëre qejfin, nisim e shajmë kryesinë... Thonë se ky komandanti juaj i ri ka eksperiencë të madhe. Ka qenë dhe në disa baza të tjera të kampit socialist, apo jo, Vullodja?

VOLLODJA — Ehu! Këtë punë e dinë të mëdhenjtë.

FATMIRI — Ç'e do se ka ardhur si kofini pas të vjelave; ne tani jemi nga fundi.

VOLLODJA — (*Shikon orën.*) Siç më thotë kjo «çajka ime», ky banket nuk paska të mbaruar.

(*Hyjnë tre marinarë sovjetikë.*)

MARINARI I — (*Atyre që janë nga deti.*) Ej, djema! E keni parë Kulikun?

MARINARI II — S'na mori malli për ta parë.

MARINARI I — Lëri shakatë. Ku djallin është futur?

VOLLODJA — Lart e keni. Është shtruar me të mëdhenjtë.

MARINARI II — Epo dikush duhet të na përfaqësojë edhe ne. (*Shpërthen.*) Ptui! Ne presim t'ia shtrojmë për largimin tonë, kurse këtu shtrohet banket për ardhjen e komandantit të ri. (*Marinari I*) Ç'e doni Kulikun?

MARINARI I — (*Troket me gisht gurmazin.*) Presim karburant dhe, për këtë punë, specialist si ai nuk gjen në të gjithë bazën tonë. . .

MARINARI III — Kuliku nuk është i zoti vetëm për këtë punë, ai është specialist për shumë gjëra.

VOLLODJA — Shumë gjëra mund të dijë vërtet, por nëndetësen ama nuk e njeh.

FATMIRI — Si radist nuk ke ç'i thua.

VOLLODJA — Por jo radist nënujës. Ende qeshin shokët që e panë ditën e parë kur hyri brenda në nëndetëse me kokë poshtë.

*(Dëgjohet zëri i Nikollait.)*

NIKOLLAI — Pra, ju falënderoj nga zemra për mikpritjen dhe më lejoni që, me rastin e emërimit tim si komandant i ri i bazës së nëndetëseve, t'ju siguroj se do të përpiqem për forcimin e mëtejshëm të kampit të madh socialist. *(Duartrokitje, të geshura, biseda, zhurmë.)*

MARINARI II — Ja, urdhëroni e mbani vesh! E dëgjuat? Na thanë të bënim gati valixhet, na përgëzuan që misionin e kryem me nder, na thanë se ekipazhet shqiptare nuk kanë nevojë për dublimin tonë, se ata mund t'i drejtojnë vetë nëndetëset, kurse tani... dreqi e merr vesh këtë punë! U kemi shkruar dhe të afërmëve që së shpejti do të jemi atje. Nuk paska gjë më të tmerrshme se sa kur njeriu përgatitet për një gjë dhe i del tjetër për tjetër...

FATMIRI — Kështu e ka ushtria, o byrazer.

MARINARI I — Nuk ka arsye që ne të rrimë më gjatë. Ne do të largohemi me siguri së shpejti; s'ka lidhje kjo punë me komandantin e ri.

*(Nga shkallët zbret Kuliku me disa kuti konservash dhe disa shishe të mbledhura në gazetë.)*

KULIKU — *(Këndon.)* Kulik, zhulik, gjdje ti bill?

Na fontankije vodku pill,  
vipill rjumku, vipill dvje,  
zakruzhillos gallavje.

FATMIRI — Ç'keni, Kulik?

KULIKU — *(Zbraz kutinë e konservave.)* Pini, vëllezër, hani, derra! Rroftë kampi! *(Nxjerr shisheet,*

u hedh diçka Vollodjes dhe Fatmirit.) Rroftë dhe uniteti! Ja, gëzuar!

MARINARI I — Kulik... Ti s'e ke shokun. Si i mblodhe gjithë këto?

KULIKU — (Tund gazetën «Pravda».) Shumë thjeshtë. I mblodha me këtë gazetë. Nuk di si m'u ndodh në xhep... kjo gazetë... Patjetër duhet të ketë diçka interesante... kjo gazetë. Pini, vëllezër! (Këndon.) Kulik, Zhulik, gjde ti bill?

Në fontankije vodku pill... (Lexon.)

Bukuresht, qershor 1960:

«Partitë komuniste dhe punëtoare do të forcojnë në kompaktësinë e vendeve të sistemit socialist botëror dhe do të ruajnë si sytë e ballit... unitetin e tyre...» Ou! Paskam mbështjellë konserva me Mbledhjen e Bukureshtit. (Ngre shishen. *Marinarit II*.) Dëgjo ti, kopuk. Me se ke dëshirë të kthehesh? Me anije mbiujëse, nënujëse apo me avion Tupolev-104? (Fatmirit.) Po ti, pse nuk pi? A nuk je rus... edhe inxhinier Skënderi nuk është rus, po e tundi me Borisin atje lart! (*Marinarit II*) Kishë bërë gati vali-xhen?

MARINARI III — Valixhen nuk e kishte bërë gati vetëm ky, por edhe unë. Po ti, pse, jo? Mjaft u talle me ne. Na e thuaj copë, di gjë ti se ç'do të bëhet? Ç'thonë ata atje lart?

KULIKU — Perënditë atje lart asgjë nuk thonë. Ka rrezik që asnjë nga ne të mos shkojë. (Fatmirit.) As ju. (Të tjerëve.) As ne! (*Marinarit III*.) Doni të dini ç'thonë ata lart? Asgjë prej gjëje s'thonë... Një banket i mërzitshëm atje lart. Heshtin. Akullnaja e Alaskës atje lart. I vetmi prush, atje lart, është Borisi me Skënderin. Ftohtësi! (Ngre shishen.) Gëzuar, vëllezër! Ju thashë, as ju, as ne! Të gjithë kë-

tu do të ngordhim. Të mëdhenjtë zihen, ne do të thehemi... më duket se do të na hanë peshqit në fund të detit... Dëgjuat, kopukë? As mbi ujë, as nën ujë, as me Tu-104! Linja Tiranë-Moskë është prishur... është prishur në Bukuresht.

*(Marinarët nisin të kërcejnë me këngën «Kulik-zhulik.» Në shkallë duket bocmani)*

KULIKU — Ej, «Aurora»! Zbrazni një herë ata topa! *(Qesh.)*

BOCMANI — Djema, lërini shakatë. Po vijnë eprorët. *(Del.)*

KULIKU — Djema! Eprorët zbresin këtu; ne, një kat më poshtë!

*(Marinarët dalin. Mbetet vetëm Vollodja e Fatmiri.)*

FATMIRI — Të isha i madh, këtij Kulikut do t'ia hiqja në vend gradën e oficerit. Tërë ditën e tërë natën tapë. Oj, ku jemi këtu!... Po zbresin.

*(Kënga tashmë ka pushuar. Dëgjohej biseda dhe zhurma. Nga lart zbresin të gëzuar e të qeshur grupe njerëzish, ndërmyjet tyre ka dhe gra oficerësh. Suzanën e shoqëron një çift i ri dhe një vajzë. Vajza i thotë: «Të lumtë Suzanë, ti recitove shumë bukur!» Nga kuverta lart, Borisi ndjek me sy Suzanën.)*

BORISI — Zanushkë!

SUZANA — *(Ndalet.)* Ah, ju Boris? *(Të tjerët largohen. Borisi afrohet. I merren disi këmbët.)*

BORISI — Suzanë, e bukur Suzanë. Nuk do ta presësh vëllanë? Skënderi tani vjen. Ç'është e vërteta, millaja Zanushka, ndoshta e tepruam pak me Skënderin, por ti mos na e vër re. Komandanti i ri, detyra të reja... Një gotë më shumë. Punë e madhe... *(Me pozë duke i zgjatur dorën.)* Të përgëzoj

për recitimin, Zanushkë... Ti je një letrare e re me të ardhme plot dritë. (*Recitan.*)

*Ti je foshnjë, foshnjë je, e di,  
po dhe unë a s'jam poet i ri?  
Sillna fllad e ledhatona, det,  
një bilbil mbi trëndafil thërret...*

A, Zanushkë! Poezia është ndjenjë delikate. Eсениni është brilant. Edhe ti mos rend pas fjalëve të ashpra gjithë tension e grindje. Art do të thotë art dhe jo thikë e bombë siç duan ta vulgarizojnë disa.

SUZANA — Po edhe arti i shërben dikujt, apo jo?

BORISI — Sigurisht, i flet zemrës njerëzore... (*E përkëdhel nga flokët.*) Ti duhet të lexosh sa më shumë dhe ç'të mundesh, Suzanë. Komunizmi nuk ka kuptim pa humanizëm dhe dashuri.

SUZANA — (*Disi e çuditur.*) Më besoni, jam e dhënë marrëzisht pas Oleg Koshevoit tuaj, çfarë humanizmi që ka ai hero!

BORISI — Ah, korniza anakronike! Heronj, sakrificë, armiqësira. Edhe Gorkit, po të ishte gjallë, do t'i vinte turp për metodën që ka shpikur. Njeriu do që të këndoje me zërin që i ka dhuruar natyra. I shkreti njeri, ka nevojë për ngrohtësi, për përkëdhelje!.. Ja, ty, si të pëlqen të të thërresin? Susi. Zanë apo Zanushkë?

SUZANA — (*E shqetësuar.*) Nuk ju kuptova!

BORISI — (*Qesh.*) E flet kaq bukur rusishten dhe nuk më kupton. (*Do ta përqafojë. Suzana i shmanget instinktivisht. Kalon Agimë. Borisi tërhiqet në një anë.*)

SUZANA — Agim! (*I afrohet e tronditur.*) Agim,

unë... ti e di Agim, Borisi është shok me Skëndërin. Nuk duhet vënë re. Ai është njeri i mrekullueshëm, di përmendsh mijëra vargje, por sonte ai...

AGIMI — Çfarë ai?!

SUZANA — Më duket i çuditshëm. Gjithçka të bukur e quan anakronike. Me siguri e ka nga dehja. Edhe tim vëlla nuk e kam parë ndonjëherë si sonte, po vazhdon ende të pijë. Shkojmë, Agim.

(*Dalin, Borisi i ndjek me sy ziliqarë. Skëndëri zbret shkallët.*)

SKËNDERI — Ku vajti Suzana?

BORISI — (*Ironik*) Me detar Agimin.

SKËNDERI — (*I merren këmbët.*) Me detar Agimin?!

BORISI — Mos e fyej dashurinë, Skëndushkë, o simpatiku i Leningradit. (*Borisi dhe Skëndëri zënë një qoshe dhe pinë. Kalojnë çifte. Ndërkohë njerëzit e pranishëm sikur ndalen për një çast. Krijohet një farë korridori. Del gjithë naze Nina, e shoqëruar nga gruaja e Arbenit, duke u uruar: «Natën e mirë!» të pranishmëve. Pas saj del Nikollai i shoqëruar nga Arbeni. Të gjithë qëndrojnë pothuajse gatitu. Nikollai nderon ushtarakisht, thotë vetëm një: «Natën e mirë, shokë!» dhe largohet. Korridori prishet, njerëzit dalin.*)

BORISI — E shikon se ç'grua ka komandanti i ri? Ninoçka, e quajnë...

SKËNDERI — Po komandant Sergein përse e hoqën.

BORISI — Budalla! Nuk thua që të ndërrohen sa më shpesh që ne të pimë nëpër bankete? (*Qesh.*) Në djall me gjithë komandantët! Ata, pa ne, inxhinierët, mbeten si peshku pa ujë. Të them si vëlla. Ky komandanti që ka ardhur nuk më pëlqen fare.

(*Kthen shishen.*) Po... edhe ai Arbeni yt se si më duket...

SKËNDERI — Arbenin tim ti nuk e njeh, prandaj sus!

BORISI — (*Thërret.*) Përse atëherë nuk të prozozon kryeinxhinier siç më bënë dhe mua? Ne shokë të një klase jemi, dhe aq më tepër që këtu ka nevojë për kuadro të pregatitur si ti. Kush është më i zoti, ti apo ai?

SKËNDERI — Ai.

BORISI — Budalla! Komandantët gradohen në kurrizin tonë, Skëndushkë! (*Kalon bocmani.*) Ja, ja, bocmani. (*Bocmanit.*) Ej, «Aurora», e mbushe hambarin me vodkë? (*Qesh.*)

BOCMANI — (*Afrohet.*) Këtu kam dëgjuar një fjalë të urtë: «Macja nuk di të pijë uthull...» (*Të qeshura. Bocmani del.*)

BORISI — Skëndushkë, ky komandanti i ri që ka ardhur...

SKËNDERI — Lëre komandantin e ri, ku vajti Sergei?

BORISI — Idiot, mjaft! Më mërzite. E pe ç'grua ishte Ninoçka?

SKËNDERI — Ti je rrufjan... Ti e ke zemrën si nëndetëse, me shumë lokale. Kurse unë e kam me një. Vetëm me një.

BORISI — Për Svetllanën tënde... (*Ngre shishen.*)

SKËNDERI — Ajo do të vijë në pushimet e verës dhe ne do të martohemi, dëgjon Borja? Do t'i ftoj të gjithë në dasmën time. (*Ngre shishen.*) Të gjithë! (*Perqafon Borisin.*)

BORISI — Po sikur dasma të mos bëhet?..

SKËNDERI — Si the, more?!

BORISI — Eh, Skëndushkë!.. Unë e di se ç'mund të bësh ti, po të dëgjosh ndonjë shpifje kundër Bashkimit Sovjetik.

SKËNDERI — (*Shpërthen.*) Kush guxon të shpifë, more?! E di ç'është për ne Bashkimi Sovjetik?.. (*Dalin.*)

VOLLODJA — (*Duke ndjekur me sy ata që ikën.*) Qënkan bërë tapë.

FATMIRI — Ju, rusët, pini shumë... dhe mbani shumë. E pe bocmanin? Eh, ç'ta kam zili, bre Vollodja! Ti je sovjetik dhe do ta shohësh më shpejt se unë komunizmin!

VOLLODJA — Gjepura! Të kam thënë: mos me politikë! Ne jemi miq e shokë e asgjë më tepër nuk na duhet. Politikën e bëjnë të mëdhenjtë... (*Ndërkohë zbresin shkallët admiralit shqiptar dhe Vollkovi.*)

VOLLKOVI — E kemi për detyrë internacionaliste, i dashur koleg, që kufijtë e kampit socialist t'i forcojmë sa më mirë...

ADMIRALI SHQIPTAR — (*Mendueshëm*) Mos u shqetësoni. Ujërat e Adriatikut gjithmonë do të jenë të kaltra, socialiste. Të jeni i sigurt për këtë!

VOLLKOVI — Hëm! Të jem i sigurt thatë? Eh, si po rrjedhin ngjarjet... e kam të vështirë të parashikoj një garanci të tillë...

ADMIRALI SHQIPTAR — Nuk ju kuptova.

VOLLKOVI — A nuk është për t'u çuditur, admiral, që në një kohë kur Partia e Leninit të madh po i afrohet me ditë komunizmit, kur jo vetëm kampi socialist, por edhe vendet kapitaliste po bëjnë përpjekje për një paqe të qëndrueshme, partia juaj...

ADMIRALI SHQIPTAR — Me sa kuptoj, juve nuk ju pëlqen qëndrimi i Partisë sonë... në një



kohë kur dhe shtetet imperialiste, thatë, po bëjnë të gjitha përpjekjet për paqe...

VOLLKOVI — Pikërisht, a nuk është kjo një kryeneçësi, kapriçio? Ti e kupton ç'do të thotë një maunë e vetmuar kundër rrymës së ujit...

ADMIRALI SHQIPTAR — (Me sarkazëm.) E kuptoj shqetësimin tuaj... Por, fundja, ç'dëm mund t'i sjellë botës një parti që është sa një pikë uji në oqean? S'besoj se përbën ndonjë rrezik, apo jo?..

VOLLODJA — Doemos. Veç rrezikut të kokës së vet, asgjë më shumë. Në mos sot, nesër Shqipëria do të rrëshqasë në prehër të imperializmit.

ADMIRALI SHQIPTAR — (Me ironi.) Ashtu? Kush jua tha këtë?

VOLLKOVI — Lenini e ka thënë: «Rrugë të mesme nuk ka!» O me ata, ose me ne.

ADMIRALI SHQIPTAR — (Me ironi.) Po sikur të bini ju në prehër të imperializmit?

VOLLKOVI — Çfarë?

ADMIRALI SHQIPTAR — (Ironik.) Vetë thatë se edhe ata e duan paqen... A nuk është njësoj?

VOLLKOVI — E kuptoj ironinë, koleg. Po mos harro se marksizmi nuk është dogmë, por shkencë në zhvillim. Të mos vësh re sot ndryshimet në botë, do të thotë të mos pranosh dialektikën, të jesh një mizantrop i mykur... Mjetet tona moderne, fjala vjen, a mund t'i krahasosh me anijet primitive të Kolombit?

ADMIRALI SHQIPTAR — Edhe mjetet tona moderne, edhe anijet e Kolombit kanë një ligj ndërtimi, skelet të fortë e bash të mprehtë për të çarë dallgët. Edhe marksizëm-leninizmi, skelet të fortë ka diktaturën e klasës punëtore dhe bash të mprehtë për të çarë dallgët reaksionare, ka partinë e vet.

3942  
GJENDËRTEK...  
GJENDËRTEK...  
NY...  
GJENDËRTEK...

VOLLKOVI — Partia përse quhet komuniste, admiral? Sepse i përket komunizmit. Dhe në komunizëm nuk do të shkojë vetëm klasa punëtore, por i gjithë populli.

ADMIRALI SHQIPTAR — Partia dhe klasa punëtore s'janë gjë tjetër veçse zemra dhe koska e popullit, Vollkov.

VOLLKOVI — Po ju, kujt ia thoni këto, një fëmije?! Harroni se përpara keni një bir të revolucionit të madh?

ADMIRALI SHQIPTAR — *(Me ironi.)* Biri i revolucionit... Edhe Napoleon Bonaparti pjeilë e revolucionit ishte, por, pasi u deh me lavdi, u bë varrmihës i tij...

VOLLKOVI — Ju merrni guxim të bëni krahasime të tilla?!

ADMIRALI SHQIPTAR — Mendoja se nuk do të prekeshit nga një krahasim i tillë, përderisa ju keni harruar përse e bëtë revolucionin...

VOLLKOVI — *(Mundohet ta përmbajë veten.)* Kjo... kjo... është një fyerje që i bëni miqësisë së singertë...

*(Hyjnë Skënderi dhe Borisi.)*

SKËNDERI — *(Borisit.)* Përralla! *(Thyen shishen.)* Pse iku Sergei? Ku vajti?! Ku?!

*(Shuhen dritat)*

## TABLOJA E DYTË

(Po ai dekor. Lëvizje marinarësh plot gjallëri. Ata mbajnë sende që i çojnë drejt nëndetësëve. Agimi po lexon diçka ulur diku në kuvertë, me shiritin e kuq të dezurnit në krah. Dëgjohet zëri i spikerit të Radio Tiranës: «Dhamë tekstin e plotë të Deklaratës së Moskës në mbledhjen e 81 partive komuniste e punëtoare të botës». Hyn Arbeni.)

VOLLKOVI — Ju qesh fytyra, admiral. Me sa duket jeni i sigurt që në lundrimin e nesërm ekipazhet tuaja do t'i marrin në dorëzim nëndetëset...

ADMIRALI SHQIPTAR — Edhe herën e parë ne nuk ishim më pak të sigurt.

VOLLKOVI — (Ndez cigaren.) Sigurisht, ju artin ushtarak e keni fituar në akademinë tonë dhe ne nuk dyshojmë në aftësitë tuaja, veçse jam kurioz të di, admiral... në qoftë se do të ndodhë ndonjë gjë, me kë do të jetë ushtria juaj?

ADMIRALI SHQIPTAR — (Rreptë.) Me këtë pyetje ju po kaloni kufijtë e një këshilltari, Vollkov!

VOLLKOVI — Ne dimë të dallojmë mirë dashurinë e popullit shqiptar dhe të bijve të tij për Bashkimin Sovjetik, për socializmin e komunizmin, nga ata që duan ta prishin këtë miqësi.

ADMIRALI SHQIPTAR — Dhe ju jeni i bindur se populli ynë e do me gjithë zemër Bashkimin Sovjetik?

VOLLKOVI — Prandaj shqetësohemi për fatin e tij. Por udhëheqësit tuaj...

ADMIRALI SHQIPTAR — Ah, udhëheqësit tanë! (*Me ironi.*) Pisk e paskeni, admiral... Sepse, pikërisht këta udhëheqës e kanë futur në gjakun e popullit tonë gjithë atë dashuri për vendin e sovjetëve.

VOLLKOVI — Ju ishit të vetmit që na kundërshtuat në Bukuresht. Enver Hoxha në Moskë sfidoi mbledhjen...

ADMIRALI SHQIPTAR — Sepse ju sfiduat revolucionin!

VOLLKOVI — Si?!

ADMIRALI SHQIPTAR — Sepse ju sfiduat revolucionin!

VOLLKOVI — Ky është një guxim i tepruar.

ADMIRALI SHQIPTAR — Vollkov, përse e mban atë yll në gjoks? Sepse ke bërë heroizma? Pra, edhe ti paske treguar guxim të tepruar kur je përleshur me armiqtë për të mbrojtur atdhenë tënd socialist. Heroizmi yt, admiral, dhe i shokëve të tu ka frymëzuar edhe partizanët tanë këtu në Shqipëri. Ndërsa sot çuditësh për një guxim të tillë!

VOLLKOVI — (*Duke shuar cigaren me nervozizëm.*) Po ti çfarë ke qenë para luftës?

ADMIRALI SHQIPTAR — Punëtor.

VOLLKOVI — (*Shpërthen.*) Edhe unë punëtor kam qenë, ta marrë djalli. Dhe ti mos më bën mua politikë. Deri në revolucion edhe unë, si ti, me hekurë jam marrë e pastaj luftë! Mjaft më! U lodhëm,

ta marrë djalli, u lodhëm. Tani, e kupton. Kam disa vjet që po marr frymë i qetë dhe më është rehatuar shpirti. Edhe ti mos u mundo të gënjesh veten. A nuk do ta doje një paqe në botë.

ADMIRALI SHQIPTAR — Përse nuk delni në pension, admiral? Vërtet qenke i lodhur...

VOLLKOVI — I leni shakatë ju lutem. (*Hesh-tje*)

ADMIRALI SHQIPTAR — Mund të më thoni, a ju ka rënë rasti të keni pasur pranë vetes ndonjë frikacak?

VOLLKOVI — (*Me mburrje.*) Njërin e kam vrarë me dorën time.

ADMIRALI SHQIPTAR — Pse e vratë?

VOLLKOVI — Si pse? Ishte frikacak.

ADMIRALI SHQIPTAR — Po përse ishte frikacak?

VOLLKOVI — Nuk më pëlqejnë këto lojëra fjalësh.

ADMIRALI SHQIPTAR — Frikacaku ëndërron për një jetë të mirë vetëm për vete, admiral, jo për shokët. Për një jetë pa telashe, të qetë, të rehatshme. Frikacaku është shumë i kënaqur kur të tjerët sakrifikojnë për rehatinë e tij. Frikacak nuk bëhesh vetëm nga e keqja, por edhe nga të mirat, që i rrëmben pa i merituar, Vollkov...

VOLLKOVI — Përse e gjithë kjo filozofi?

ADMIRALI SHQIPTAR — Më thatë se keni qenë punëtor gjithë jetën dhe...

VOLLKOVI — Dhe pastaj?

ADMIRALI SHQIPTAR — Dhe pastaj... mbase, po ta kishe lënë gjallë atë frikacak, sot ai do të ta kishte zili këtë rehati dhe paqe të amëshuar që kërkon...

VOLLKOVI — Çfarë?!

ADMIRALI SHQIPTAR — Edhe aristokracia e klasës punëtore në vendet kapitaliste, sapo majmet, nuk çan kokën fare për hallet e punëtorëve...

VOLLKOVI — (*I nxehur.*) Ju na vini në një radhë me tradhëtarët e klasës punëtore në vendet kapitaliste?!

ADMIRALI SHQIPTAR — Jo, admiral. Jeni ndryshe. Aristokracia juaj ka pushtetin.

VOLLKOVI — (*Shpërthen.*) Unë do të protestoj për këtë!

ADMIRALI SHQIPTAR — Ju më pyetët me kë do të jetë ushtria jonë dhe unë isha i detyruar t'ju përgjigjesha! Ç'mbjell, korr. (*Dalin në drejtime të kundërta me njëri-tjetrin. Hyjnë marinarë me sende në krahë. Vollodja mban një arkë së bashku me Fatmirin. Ata e ulin arkën përtokë.*)

FATMIRI — (*Duke ngrënë, i jep një copë byrek Vollodjas.*) Na! Është lakror shtëpie. (*Vollodja nis ta hajë.*) Ma ka bërë nëna. Po ti pse nuk erdhe të takoheshe me babanë tim. E di si më tha im atë?

«— Mos më hajde në shtëpi pa më sjellë atë sovjetikun tënd.

— E, mor baba, — i thashë — tani ai sovjetiku im do të shkojë në shtëpi të vet, se e kreu detyrën. — Por kur i thashë: — E, mor baba, t'i kishim edhe ne këto male, fusha si në Bashkimin Sovjetik — e di si m'u përgjigj?

VOLLODJA — Hë?

FATMIRI — T'u mbushtë goja me bajgë, — më tha — këto male na kanë mbajtur gjallë.» (*Qesh. Hyn bocmani dhe disa marinarë të tjerë*) Pse u ndanë ashtu dy admiralët?

VOLLODJA — Të kam thënë, vëllaçko, jo me politikë, ha byrekun!

BOCMANI — (*Shikon Vollodjan me Fatmirin.*) Aj, aj, aj, ia paskeni shtruar muhabetit, ë? (*Vollodja dhe Fatmiri çohen. Vollodja merr arkën në kurriz dhe nisët.*) Shpejt, djem, shpejt! Nesër na pret lundrimi. Komandantët, lart në mbledhje, po marrin masa. Edhe ne, o burrani, ta kemi gjithçka gati. Apo jo, Agim! (*Disa marinarëve shqiptarë.*) Hajdeni, trimat e xhaxhait, nesër të na nderoni! Bukuri! Bukuri! Shpejt, djem, shpejt! Ashtu de! (*Del së bashku me të tjerët.*)

(*Fatmiri i afrohet Agimit.*)

FATMIRI — E more vesh? U ndanë më dysh.

AGIMI — Si?!

FATMIRI — Komanda jonë është mbledhur në një krah, ajo e sovjetikëve në krahun tjetër. Asnjëherë s'i kam parë kështu, veç e veç.

AGIMI — E dëgjove deklaratën e Mbledhjes së Moskës?

FATMIRI — Po ja, kjo, bre Agim, më çudit. Ne po veçohemi, kur deklarata quhet e përbashkët?..

AGIMI — E di ç'ke ti? Mos llap shumë!

FATMIRI — Dëgjo Fatmirin ti. Unë jam filxhan kafeje. Ma thotë mendja se punët nuk shkojnë mirë. . .

AGIMI — (*Rreptë.*) Fatmir! (*Heshtje.*)

FATMIRI — Ti je frikacak, Agim. . .

AGIMI — Si the?..

FATMIRI — Frikacak thashë. Ja kështu de, oj!

AGIMI — Unë frikacak?

FATMIRI — Po, po ti. Edhe ti vetë e ndjen se diçka po tronditet, por nuk ta mban të flasësh.

Pse u ndanë admiralët ashtu, njëri andej, tjetri këtej? Pse?

AGIMI — Të këshilloj, si shok, ta kyçësh, Kup-ton?

FATMIRI — Ti, ose trembesh, bre byrazer, ose s'merr vesh fare nga politika. Ja kështu de, oj! (*Hyn Kuliku.*) Gimçe, se si më duket ky Kuliku kur e shikoj. A të kujtohet kur na erdhi? Një ditë e kapa duke pirë alkoolin e pastrimit të aparateve të nëndetëseve. Se si më duket kur e shikoj. Ja, edhe tani po vjen vërdallë. Mos ia hidh sytë. Kushe-di ç'bluan. Mbase i ka hipur në kokë për të pirë. (*Kuliku drejtohet për te nëndetëset.*) Më plaçin sytë po nuk është nisur për atje. Do t'i qepem. (*Del.*)

ZËRI I ROJES — Ndal! Përgjegjës i ndërresës!

AGIMI — Lejoje! (*Hyn Nina.*)

NINA — Dua Nikollain, komandantin.

AGIMI — Posi. Ja tani. Uluni ju lutem. (*Merr receptorin e telefonit. Nina tregon shenja padurimi.*) Alo! Komandant Nikollai? Ju ka ardhur gruaja. (*Ninës.*) «Të prisni pak,» thotë.

NINA — (*Me nervozizëm.*) Çfarë? Të pres? (*Me ton urdhërues.*) Tani të vijë, urgjent!

AGIMI — (*Në telefon.*) Alo! Shojja thotë se duhet të vini patjetër. (*Ninës*) «Përse keni ardhur?», pyet.

NINA — (*Ia rrëmben telefonin.*) Nikollai, ti loj-te nga mendtë?! Edhe pyet? Ku e ke çelësin e kasa-fortës? Në xhep? (*Qahet.*) Uuh! Ti je i padurueshëm, Nikollai! Në magazinë kanë dalë qilima Korçe... Dëgjon? Si? Je në mbledhje? Uh, dreqi e marrtë mbledhjen tënde! Më dërgo çelësin me shoferin! Ka shkuar në park? Ah... (*Mbyll telefonin me inat.*) Durak! (*Agimit, e nervozuar.*) Ku parku, parku ku?



AGIMI — (*I çuditur.*) Parku? Ja, andej nga erdhët. (*Nina del. Hyn me vrap Borisi me vështrim andej nga u largua Nina.*)

BORISI — Gruaja e Nikollait ishte ajo?

AGIMI — Si urdhëron! E mbaruat mbledhjen?

BORISI — Jo, mbledhja nuk ka mbaruar.

AGIMI — Besoj se ju jeni dakord që pala jonë nesër t'i marrë në dcrëzim nëndetëset, apo jo?

BORISI — Kjo varet nga ju, por nuk më thatë, ç'kërkonte këtu ajo? (*I afrohet buzagaz.*)

AGIMI — Të shoqin.

BORISI — Edhe ti, pëllumbi im, nuk di ta hedhësh keq spirancën.

AGIMI — S'po ju kuptoj.

BORISI — Suzana më ka folur gjatë për ty.

AGIMI — Edhe ajo më ka folur për ju.

BORISI — Eh, miku im! Femra është enigmë...

AGIMI — Si thatë?!

BORISI — Më praktik, pëllumbi im. Romantizmit i ka ikur koha. Përndryshe, mosha e saj e re do të shpërthejë diku tjetër.

(*Këndon.*)

Andej jepmu mikja ime,  
se një herë rron mbi dhe.

AGIMI — (*I prekur.*) Më vjen keq, shoku Boris, që ju...

BORISI — (*Ironik.*) Që unë?..

AGIMI — (*Shpërthen.*) Vallë kështu si ju janë njerëzit sovjetikë! (*Hyn Kuliku i alarmuar. Atë e pasojnë Fatmiri, bocmani dhe disa marinarë të tjerë.*)

KULIKU — (*Çirret.*) Pse, ç'u bëmë këtu? Kamp përqëndrimi me roje nga pas? Shoku Boris, këta po na ngjiten nga pas si fantazma. (*Tregon Fatmirin.*) Ja, e shikoni? Edhe në nevojtoje nuk m'u nda.

FATMIRI — (*I revoltuar.*) Jo në nevojtoje, po në akustikë! Ç'të duhej ty në akustikë? Pse i lëvizje çelësat? Ti je radist dhe pikë. Oj!

KULIKU — Çfarë çelësash? Shoku Boris, këta po na e bëjnë jetën skëterrë. Nuk po na lënë të marrim as frymë. Njerëz jemi, duam të shkëmbejmë ndonjë fjalë me shokët, dreqi e mori!

FATMIRI — Kur hyre ti, në akustikë s'kishte njeri. Pse e mbylle derën nga brenda?

KULIKU — E dëgjon! Më ka përgjuar. Këta dyshojnë te ne...

FATMIRI — Unë nuk kam pse dyshoj. Të pashë me këta sy. Ja kështu de, oj!

KULIKU — Kjo është e tmerrshme. Ku jemi këtu, në Mathauzen?

BORISI — Kulik, merre këtë dhe shifroje. (*Fatmiri.*) Ti, djalosh, në vend që t'u qepesh si hije njerëzve tanë, më mirë shko e përvetëso detyrën për lundrimin, që të mos dëgjojmë pretendimet tuaja. (*Kuliku del.*)

AGIMI — Më falni, që po ju pyes, po për çfarë pretendimesh e keni fjalën, shoku Boris?

BORISI — Ç'kujtoni ju? Se mund të drejtoni nëndetëset? Pandehni se keni arritur të drejtoni këtë teknikë kaq të ndërlikuar. Mos t'ju gënjejë mendja, detar Agimi.

AGIMI — Po ju vetë i keni vlerësuar pa masë ekipazhet tona.

BORISI — Këtu qëndron e keqja. Fjalët e mira ju i keni marrë si gjykim përfundimtar dhe jo thjeshtë për inkurajim. Dhe ja tek po ta them, në qoftë se do të provoni të lundroni nesër pa dublantë, do të nguleni në fund të detit me hundë në rërë.

AGIMI — Kjo s'ka për të ndodhur kurrë! Edhe sikur marinarët tanë të lundrojnë me sy mbyllur.

BORISI — Sipas teje, ne jemi kot këtu?

AGIMI — Jo, unë nuk desha të them këtë, por...

BORISI — Preji fjalët! Këtë do ta shohim nesër. Do të shohim dhe se si janë njerëzit sovjetikë, gallupçik. (Del.)

BOCMANI — (I menduar pas një heshtjeje të gjatë.) Mos ua vini re inxhinierit dhe atij, Kulikut. (Heshtje.) Mos qëndroni kështu kokëvarur, djem! Kaq vjet si vëllezër. Pse ta prishim ditët e fundit? Turp! Hajdeni, merriani një kënge shqiptare, ruse, çfarë të doni. (Këndon.) Oj, ti, Vollga, Vollga. (Asnjë nuk e pason.) Davaj, Agim! (Këndon.) «Bashkohu, shok, me ne në çetë.» {Asnjë nuk këndon. Bocmani përtypet i vrarë shpirtërisht, por nuk e jep veten. Marinarit të dytë.) Ej, Filipov, nesër kemi lundrim dhe në fund të javës ti kthehesh në Odesën tënde. Tunde! Shko merre kitarën. Do të ikim nëpër shtëpitë tona, nuk ka si familja. Këtë jua thotë një detar i vjetër. Vollodja! Edhe ti do t'i shohësh pleqtë e tu. (Vollodja dhe Fatmiri largohen.) Hajdeni, djemtë e xhaxhait, t'ia marrim valles. Ja, erdhi e nesërmja. Nëndetëset janë në duar të sigurta. (Nis të kërcejë duke thirrur.): «Ehej! Ehej! (Të gjithë largohen. Në skenë mbetet bocmani i dërmuar, që mundohet ta përmbajë dhembjen, dhe Agimi i heshtur)

AGIMI — (I menduar.) Asgjë s'po merret vesh, bocman. Një komandant ikën, një komandant vjen. Përse nuk po na i dorëzoni nëndetëset? Ne nuk do-  
lëm keq, apo jo?

BOCMANI — (Krenar, i përmbajtur.) — Unë Mashës sime i kam thënë: «Sa të jem ushtar i par-tisë, nuk dihet se kur kthehem në shtëpi.» Kampi

ynë ka më shumë halle se gruaja ime. (*Nis të largohet. Agimi e ndjek me sy. Bocmani kthehet vrullshëm dhe i hedh dorën në qafë.*) Agim, more bir... Vërtet ç'po ndodh me ne kështu? (*Me vete.*) Po përse vallë? (*Del kokulur. Nga shkallët zbresin Vollkovi dhe Nikollai, pas tyre hyn Kuliku.*)

KULIKU — Radiogram nga Moska, shoku admiral.

VOLLKOVI — Mbledhja e partisë të bëhet në kajutën time në orën një të natës. Qartë?

KULIKU — Qartë, shoku admiral!

VOLLKOVI — (*Lexon radiogramin. Pastaj Kulikut.*) Inxhinier Borisi më njoftoi se nuk arritët ta plotësonit detyrën...

KULIKU — Ishte e pamundur, shoku admiral. Nga pas më ndoqi një marinar i këtyre dhe s'm'u shqit asnjë hap.

VOLLKOVI — Keq, shumë keq, toger Kasatov. Moskryerja e kësaj detyre na hap telashe. Në lundrimin e nesërm do ta kemi të vështirë të bëjmë ndonjë gjë. (*Heshtje.*) Si është morali i ushtarëve tanë?

KULIKU — Ndjehet një farë hutimi i përgjithshëm. Disa kanë filluar të pinë pa masë. Mendoj se bocmani do të na hapë telashe.

VOLLKOVI — Bocmani kështu?.. Po nga pala shqiptare?

KULIKU — Kemi vështirësi.

VOLLKOVI — Tjetër?

KULIKU — Asgjë të re.

VOLLKOVI — Mirë, shko tani!

(*Vollkovi dhe Kuliku dalin. Nikollai i afrohet Agimit.*)

NIKOLLAI — (*Agimit.*) Përse erdhi këtu ime shoqe? Asgjë nuk mora vesh në telefon.

AGIMI — Ajo tha se kanë dalë qilima dhe...

NIKOLLAI — Vërtet, qilima Korçe?

AGIMI — Po.

NIKOLLAI — Parkun, të lutem.

AGIMI — Makinën e mori...

NIKOLLAI — Kush?

AGIMI — Gruaja juaj.

NIKOLLAI — (*Qetësohet, buzëqesh.*) Ah, me siguri do të jetë zemëruar me mua, Agim! Ka gjetur të holla borxh dhe ka shkuar në dyqan. Nejse, këto janë vogëlsira të zakonshme të jetës. (*Heshtje.*) Me sa mora vesh, sot nuk jeni ndarë mirë me toger Borisin...

AGIMI — T'ju them të vërtetën, shoku Nikollai, nuk u përmbajta. Ai...

NIKOLLAI — E di, Agim, e di. Ti ke një farë të drejte. Borisi është disi i shturur. E, të tillë njerëz ka raste që katandisen më indiferentë ndaj problemeve të mëdha që shqetësojnë shoqërinë, çështjen e paqes dhe të socializmit në botë. Kjo është e rrezikshme, shumë e rrezikshme. (*Ndërron tonin e të folurit.*) Po si i the Borisit? «Kështu si ti janë njerëzit sovjetikë, ë?» (*Qesh.*) Sigurisht, Agim, njerëzit sovjetikë nuk mund të jenë të tillë. Por ti duhet të kuptosh se intelektualët kanë teka profesionale. Mos harro që ky shekull i përket mendjes së shkencëtarit. E ke vënë re? Inxhinierit i heqin kapelën gjithë punëtorët, ndërsa punëtorit, inxhinierët...

AGIMI — (*Me sinqeritet, buzagaz.*) Kjo tregon se punëtorët janë më të sjellshëm se intelektualët.

NIKOLLAI — (*Qesh.*) Ashtu? Bukur!

AGIMI — (*I qeshur.*) Imagjinoni, shoku Niko-

llai, kur të gjithë ne, punëtorët e fshatarët, të jemi të mësuar e të dimë të qeverisim, ministrit nuk do t'i duket më vetja ministër, por shërbëtor i këtyre njerëzve që prodhojnë të mirat e jetës.

NIKOLLAI — Më pëlqen shpirti yt proletar, Agim. (*Kujtohet.*) Nuk më thatë, cili qe shkakui i grindjes suaj me toger Borisin?

AGIMI — (*Ngriset.*) Ndoshta mua nuk më lejohehet t'i flisja shokut Boris aq pa takt. Po, kur dëgjovala se po tallej me cinizëm, si një tregtar ndjenjash, m'u errën sytë. A mund ta quajë veten të lirë njeriu në qoftë se nuk çlirohet nga cmira, egoizmi. . .

NIKOLLAI — (*E ndërpret.*) Detar Agimi, e admirtoj guximin tënd, por jo kaq të tepruar. . . Borisinuk është biri i dokujtdo. I ati, mareshal i Bashkimit Sovjetik, nderohet nga një botë e tërë. Nejse, ti je i ri dhe. . .

AGIMI — Ju betohem, shoku Nikollai, se më vjen plasje që u grinda me të, por nuk kisha rrugë tjetër. Më besoni, qysh fëmijë, pas fjalëve «Parti» dhe «Enver,» fjalët që më kanë mësuar prindërit janë «Bashkimi Sovjetik» dhe «Stalini.»

NIKOLLAI — (*Buzëqesh.*) E, Agim, Agim! Dëgjon njeriu sovjetik këto fjalë të arta, të singerta dhe mbushet me krenari të ligjshme. . . Mirë thonë klasikët: «Proletarët nuk kanë atdhe, por ideal, komunizëm».

ZËRI I NINËS — (*Nga brenda.*) Kolja!

NIKOLLAI — Nina, ime shoqe. (*Vazhdon.*) Në botë ka probleme të mëdha, të koklavitura dhe ne, proletarëve, na bie barra për t'i zgjidhur, Agim. . .

ZËRI I NINËS — Kolja!

NIKOLLAI — Ninoçka, e bleve qilimin? Bukur. Ki durim, dō të vij ta shoh. (*Vazhdon.*) Pra desha

të them, Agim, se ti je një proletar i vërtetë dhe ne, proletarët, nuk kemi atdhe, por ideal, e kupton, ideal.

ZËRI I NINËS — Kolja!

NIKOLLAI — (*Buzëqesh.*) Sa më afër vjen komunizmi, aq më të pangopura bëhen gratë. (*Nikollai del.*)

AGIMI — (*E ndjek me sy duke ngritur supet.*) Komunizmi?! Jo! Kjo rrugë nuk të çon në komunizëm.

(Shuhen dritat.)

Në paraskenë.

(*Në gjysmerrësirë, Vollkovi, Nikollai. Borisi, bocmani dhe disa oficerë të tjerë sovjetikë.*)

VOLLKOVI — Pra, e përsëris! Asnjë nëndetëse në dorë të shqiptarëve. Ata duhet ta kenë të qartë se pa ne nuk mund të jetojnë as 24 orë...

BOCMANI — (*Ngre dorën.*) Me leje? (*Çohet.*) Po... me sa di unë, nëndetëset sikur janë të shqiptarëve, apo jo? Për këtë sikur ka edhe dokumente midis shteteve tona, apo jo? (*Ndihet një atmosferë habie.*)

VOLLKOVI — (*Duke e përmbajtur nervozizmin, nuk ia hedh sytë fare bocmanit, por i drejtohet Nikollait.*) Komandant Nikollai, ç'janë këto gjykime të vartësit tuaj? Përse të ka sjellë partia këtu? Të ruash rosat? Ende nuk e paskan të qartë vartësit se Partia e Punës e Shqipërisë ka tradhëtuar kampin socialist? Për hir të një firme burokratike u dashka t'ua lëmë mjetet në dorë të shiturve, që pastaj të na vrasin me armët tona?! Besnikëria ndaj vendit të sovjetëve në situata të tilla duket, komandant Nikollai.

BOCMANI — (*I indinjuar.*) Si thatë, besnikëria? Po ju nuk më njihni sot, shoku admiral... Ne bashkë kemi mbrojtur Leningradin. Duhet t'ju kujtohet ai marinari që e quanit të tërbuar se ishte plagosur gjashtë herë dhe nuk pranonte të tërhiqej nga zjarrri... Ju kujtohet, apo e keni harruar, shoku Vollkov? (*Vollkovi vështron rreptë Nikollain.*)

NIKOLLAI — Preji fjalët! Ulu, bocman! (*Vollkovit.*) Ju keni shumë të drejtë, shoku admiral. Por, ja që... ndodh të mos na kuptojnë edhe njerëz me merita, që kanë derdhur gjak për këtë parti... dhe ka raste që këta shokë, duke u mburrur me të kaluarën, arrijnë që sot të bëhen pengesë dhe...

BOCMANI — (*I vrarë shpirtërisht.*) Çfarë do të thotë kjo, shoku Vollkov

VOLLKOVI — (*Nikollait.*) Kini kujdes, komandant Nikollai! Vartësit duhet të të ankohen ty dhe jo mua... Këto probleme t'i shikojë mirë zëvendësi juaj për punë politike dhe jo të qahet se nuk ia dëgjojnë zërin...

BORISI — Nuk e di në do të më lejonit të merrja fjalën, shoku admiral?

VOLLKOVI — E hë!

BORISI — Unë mendoj se të metat nuk duhen kërkuar vetëm te vartësit, por edhe te ne, eprorët. Të themi të drejtën, komandant Nikollai duhet të jetë më i rreptë, më i rreptë duhet të jetë! Muja personalisht më ka ardhur keq që shoku Nikollai i flet me përzemërsi një provokatori, një marinari shqiptar, që ka arritur të më fyejë edhe mua... Vallë, me buzëqeshje luftohet armiku?

VOLLKOVI — Si e quajnë marinarin?

BORISI — Agim.



(*Nikollai i thotë diçka në vesh admiralit dhe ai aprovon me kokë, Borisi e kap këtë moment.*)

BORISI — Ju lutem, të më kuptoni drejt, shoku admiral. Komandant Nikollai është kuadër mjaft i përgatitur, por ne jemi komunistë dhe, kur shohim ndonjë të metë, edhe tek eprorët tanë, kritikojmë me kurajë bolshevike...

VOLLKOVI — Tjetër, Boris?

BORISI — Unë kisha dhe diçka tjetër, por ne jse...

VOLLKOVI — Vazhdo, vazhdo!

BORISI — Po ja, fjala vjen, sot, kur ne po zhvillojmë këtë mbledhje kaq të rëndësishme, kur ndodhemi në mes të tradhëtarëve të kampit socialist, shoku Nikollai ka dërguar makinën me gjithë gruan në Tiranë. Dhe përse? Sepse këtu në Shqipëri, libri sovjetik u shitka me gjysmë çmimi dhe, sigurisht, kjo gjë dyfishon bibliotekën personale. Po a është e drejtë, shokë, që ne të tregohemi tregtarë në sy të armikut? Kjo, më duket, nuk përputhet me figurën morale të njeriut sovjetik...

NIKOLLAI — (*I shqetësuar.*) Mos vallë sjellja juaj e shturur përputhet me figurën morale të njeriut sovjetik, toger Borisi? Më falni, shoku admiral, për ndërhyrjen, por këtu po merret nëpër këmbë, me të padrejtë dhe me qëllime jo të mira, dinjiteti im.

BORISI — Kjo është thjesht hakmarrje nga ana juaj, shoku Nikollai.

NIKOLLAI — Shoku Vollkov...

VOLLKOVI — Unitet, unitet! Në një situatë të tillë, Boris, duhet unitet dhe jo përçarje. (*Nikollait.*) Në luftë dëgjohet vetëm një kambanë, urdhri i komandantit. Qartë?

NIKOLLAI — Si urdhëron, qartë, shoku admiral!  
(*Shpërndahen. Në skenë mbeten vetëm Borisi dhe Nikollai.*) U mundove të fitoje pikë përpara admiralit mbi kurrizin tim, toger Borisi. Por duhet të dish se mua më quajnë Nikollai dhe jo Sergei...

BORISI — (*Buzëqesh me cinizëm.*) Babai im është më i madh edhe se ti, edhe se admiral, shoku Nikollai. Mos e harro këtë...

(*Ata dalin. Shuhen dritat.*)

## TABLOJA E TRETË

*(Po ai dekor. Arbeni i afrohet Skënderit dhe ndez cigaren.)*

SKËNDERI — E pabesueshme! M'u dukën të pabesueshme ato që na tha në mbledhje admirali ynë. As në ëndërr s'më ka shkuar ndërmend një gjë e tillë.

ARBENI — Tani po duket sheshit tradhëtia e tyre. Vështirë e kemi. Gjithë partia vështirë e ka. T'u thuash punëtorëve të botës se ylli i Kremlinit po i çon në humnerë, kjo është një luftë titanike.

SKËNDERI — U kishim besuar gjithçka të shtrenjtë, u kishim besuar me zemër në dorë miqësinë, dashurinë, ndjenjat tona, mendimet tona... E dini? Unë atje jam fejuar me një vajzë; Svetllanë e quajnë. Pse t'jua fsheh? E dua si veten.

ARBENI — *(Qortues.)* Skënder!

SKËNDERI — Shoku Arben, ju kuptoj. Ajo është një vajzë shumë e mirë. Ne me të kishim të njëjtat ëndrra, qëllime, ideale. Unë... unë...

ARBENI — *(I rreptë.)* Ç'janë këto dufe melodramatike, inxhinier Skënderi? Të kam thirrur të më japësh mendim, ç'duhet bërë për difektin dhe jo të më qahesh për Svetllanat e tua...

SKËNDERI — (I prekur.) Ju nuk keni të drejtë të më fyeni, shoku Arben.

ARBENI — (I nervozuar). Si, more, nuk paskam të drejtë të të fyje? A nuk e shikon ç'bëhet? Ata nuk duan të na dorëzojnë nëndetëset. Po largojnë nga vendi ynë gjithë specialistët. Studentët tanë po na i kthejnë, Pallatin e Kulturës na e lanë si varr në mes të Tiranës, kurse ti, ti...

SKËNDERI — Nejse... Ndoshta unë nuk duhej t'ju flisja kaq singerisht.

ARBENI — Si the, more? Dëgjo këtu! Për ideal, për ideal të them, të ishte situatë tjetër, do të të hyja vendshe. Dëgjove? «Dëgjova», thuaj! Oj, s'duhej të flisje singerisht! Kujt ia thua këto ti, more, ë? Ne mbi të gjitha jemi shokë dhe sahanët i kemi pa kapak, dëgjove? «Dëgjova», thuaj! Qaraman! Fol, ç'duhet të bëjmë për difektin?

(Hyn Agimi.)

AGIMI — Difekti u shkaktua për faj të toger Borisit, shoku komandant. Ai urdhëroi një marinar të ngrinte periskopin në kohën kur lundronim me shpejtësi. (Hyjnë Nikollai, Borisi, bocmani.)

NIKOLLAI — Atëherë, shoku Arben, të mos humbasim kohë. Difekti, siç e theksojnë inxhinierët tanë, mund të ndreqet vetëm në Sevastopol. Koha nuk pret. Mos të harrojmë se, me gjithë përpjekjet tona, ekipazhet tuaja nuk kanë arritur të marrin nëndetëset në dorëzim. Nuk dua të fyje ekipin komandues, por niveli i marinarëve tuaj, me thënë të drejtën, le për të dëshiruar.

ARBENI — Marinarët tanë janë në vitin e tretë, Nikollai. Ndërsa tuajt porsa janë veshur.

NIKOLLAI — Të mos largohemi nga kryesorja, fjalën e kemi për difektin.

ARBENI — Inxhinier Skënderi, ju ç'thoni?

BORISI — Skënderi nuk është inxhinier më pak i zoti se sa unë, komandant Arbeni. Ai e di se teknika moderne ka ligje dhe disiplinë shkencore. Dhe këtë disiplinë s'mund ta gjesh në këtë kovaçanën e këtushme...

ARBENI — Toger Borisi, nuk ju pyeta!

BORISI — Sâ për kuriozitet, desha t'ju them që unë dhe Skënderi e kemi mbrojtur diplomën në një ditë.

SKËNDERI — Më duhet të shoh skemat, shoku komandant.

*(Arbeni shikon Nikollain.)*

NIKOLLAI — Të kuptohemi, shokë. Skemat, dokumentat e nëndetëseve, në fund të fundit, tani që ju ende nuk i keni marrë në dorëzim... ju lutemi mos na vini në pozitë të vështirë për të na i kërkuar.

ARBENI — Po pa skema, Skënder, nuk mund të rregullohet difekti?

SKËNDERI — Sigurisht! Por puna është të shkurtohet koha.

AGIMI — *(Arbeni.)* Shoku komandant, janë deformuar vetëm bokullat drejtuese të periskopit. A nuk mund të hiqen dhe të ritornohen? Dhe kjo mendoj se mund të rregullohet brenda një jave. Ndërsa, po të shkojë mjeti në Bashkimin Sovjetik dhe të kthehet, do afërsisht, një muaj.

NIKOLLAI — Sikur të mos e njihja detar Agimin, do ta merrja për një djalë të pasjellshëm.

AGIMI — Të më falni në qoftë se s'mora leje. Por, ne këtu po konsultohemi, shoku Nikollai...

NIKOLLAI — Ti, Agim, ke vërtet më tepër kulturë se bocmani ynë, por ai ka tre vjet që po të mëson detyrën e rëndësishme luftarake. Të paktën respektoje nga thinjat... (*Bocmanit.*) Bocman nxënësi yt thotë që difekti rregullohet këtu për një javë. Po ti, ç'thua?

BORISI — Komandant Nikollai, unë jam kuadër i lartë, inxhinier, dhe ju kërkoni mendimin e një bocmani?!

NIKOLLAI — Fol, bocman!

BOCMANI — (*I zënë ngushtë.*) Këtu ka inxhinierë, shoku komandant, ç'më pyesni mua...

NIKOLLAI — Jepi përgjigje nxënësit tënd, Bocman! A mund të rregullohet këtu difekti?

BOCMANI — (*Pas një heshtjeje.*) Jo!

NIKOLLAI — Pra duhet shkuar sa më parë në Bashkimin Sovjetik?

BOCMANI — Po!

NIKOLLAI — E dëgjove mjeshtrin tënd, Agim?

AGIMI — (*Arbenit.*) Shoku komandant, difekti mund të ndreqet këtu brenda një jave. Për këtë garantojnë mësimet e vlefshme që më ka dhënë ky njeri, që sot po mundohet të gënjejë vetveten.

NIKOLLAI — Pa shih, pa shih... presione psikologjike. E dëgjoni, shoku Arben?

ARBENI — Unë aprovoj mendimin e Agimit.

NIKOLLAI — Ashtu? Mos harroni se për këtë vendosin eprrorët. Dhe ata janë më të logjikshëm se sa ju.

ARBENI — Nëpër detyra, shokë! (*Del Skënderi, nga ana tjetër Agimi me bocmanin.*)

BOCMANI — (*Me zë të ulët.*) Ti mos luaj nga ajo që propozove, Agim.

AGIMI — Si?

BOCMANI — Difekti duhet të rregullohet këtu. Dëgjomë mua!

AGIMI — (*I ngrysur.*) Më neveriten në kulm njerëzit me dy fytyra, bocman.

BOCMANI — E di, mor bir, e di... Por ti, megjithatë, dëgjomë kësaj here! Difekti duhet të rregullohet këtu, a merr vesh?

AGIMI — (*Rreptë.*) Edhe pa këshillat e tua. Kështu qosheve, unë jam i qartë, bocman! (*Dalin.*)

NIKOLLAI — (*Arbenit.*) Ju i besoni fjalëve të një marinari, që kryen detyrën e bocmanit, shoku Arben...

ARBENI — Po kujt vallë duhet t'i besoj? Përse nuk zbatoni kontratat, kapiten? Ku janë pjesët e këmbimit, pajisjet, armatimet. A përputhet kjo me kartën e Traktatit të Varshavës.

NIKOLLAI — (*Ironik.*) Këto janë gjëra që s'ngrenë peshë, shoku Arben. Ato i zgjidh një vapor i vetëm dhe vaporit është nisur. Por, të mos largohemi nga difekti. Me qëndrimin tuaj ju do të diskreditoheni përpara eprorëve. I besoni fjalës së një mekaniku të thjeshtë. E kuptoj, udhëhiqeni nga principi i mbështetjes në klasën punëtore. Po cilës klasë punëtore i shërben partia juaj, përderisa te ju, punëtorët ende nuk janë pjekur si klasë? Ja, që këtej nis demagogjia...

ARBENI — Punëtorë ka në të gjithë botën, kapiten Nikollai. Rëndësi ka në cilin vend udhëheq ideologjia e tyre.

NIKOLLAI — Ju keni një proverb të bukur: «Hajde, baba, të të tregoj arat.» Shqipëria në çdo hap ka ndjekur eksperiencën e ndritur të Bashkimit Sovjetik, ndërsa tani...

ARBENI — (*Me sarkazëm.*) Edhe tani ne ju je-

mi mirënjohës... Eksperienca juaj po na bën më tepër vigjilentë... Ju falem nderit për këtë! (*Del.*)

BORISI — E di si e duan këta, Nikollai? Ash-tu, siç ia bëri një huligan yni një kursanti polak në ucilishten e Leningradit. Huligani i kërkoi orën e dorës, polaku nuk ia dha. Atëherë huligani e detyroi polakun jo vetëm t'i jepte orën e dorës, por edhe të hiqte viza me shkop nëpër dëborë. (*Qesh.*) Ta shihje kur na erdhi polaku në postbllok të shkollës vetëm me të mbathura... (*Qesh, vrenjtet.*) Kësh-tu e duan edhe këta. Dhe jo ashtu, urtë e butë, siç e keni nisur ju.

NIKOLLAI — Toger Borisi! Detyra jote është inxhinier Skënderi dhe jo këto këshilla bajate.

BORISI — Nikollai, ju silleni me mua më keq se me ata?!

NIKOLLAI — Në ushtri dëgjohet një kambanë, urdhri i komandantit, qartë? (*Borisi tund zinxhirët. Nikollai shpërthen.*) Mjaft m'i tunde ata çelësa!

BORISI — (*Ironik.*) Këta çelësa kanë tingull më të fuqishëm se kambana jote, Nikollai... (*Ndërkohë hyn Agimi dhe bocmani duke mbajtur së bashku diçka në supe.*)

NIKOLLAI — Detar Agimi! (*Agimi shkarkohet dhe shkon te Nikollai, i cili i buzëqesh në mënyrë intime.*) E, Agim, Agim. Ngjarjet kanë marrë një drejtim të atillë, saqë e kemi të vështirë të besojmë njëri-tjetrit. Të kam çmuar për djalë të mprehtë. Unë jam po ai Nikollai që ti ke njohur, dhe ti je po ai Agim që unë njoh, i zgjuar, i ndershëm, me aftësi dhe të dhëna jo për një bocman të thjeshtë, por dhe...

AGIMI — Kapiten Nikollai, unë kam një shokun



tim lustraxhi dhe, kur ndonjë nga klientët kërkon që këpucët t'i shkëlqejnë shumë, ai lustraxhiu, përveç bojës dhe xhelasë, ia lyen edhe me benzinë. Mirëpo benzina prish këpucën, çan lëkurën. . .

NIKOLLAI — Morali i kësaj fabule?

AGIMI — Shumë i thjeshtë. Unë, pra, nuk jam nga ata klientë që më pëlqen shkëlqimi i tepërt.

NIKOLLAI — (*Shpërthen.*) Hapi sytë mirë, Agim! Po të flet zëri i vendit të sovjetëve, për të cilin ti ke belbëzuar qysh fëmijë. . .

AGIMI — (*I prerë.*) Ç'kërkoni nga unë, kapiten?

NIKOLLAI — E ç'mund të dojë njeriu sovjetik nga një proletar? Asgjë, veç së vërtetës. Ti duhet të bindesh se difekti nuk rregullohet këtu. Inisiativa jote vërtet është për t'u lavdëruar, por ti e dëgjove kryeinxhinierin tonë. . .

AGIMI — (*Shpërthen.*) Hapni rrugën! (*Del*)

(*H e s h t j e .*)

BOCMANI — (*I menduar dhe kokulur.*) Çfarë po bëjmë kështu, shoku Nikollai? Mashtrojmë, gënjejme. . . A është e ndershme kjo? Ne jemi komunistë.

NIKOLLAI — Dhe ti si komunist bën atë që të thotë partia.

BOCMANI — Po partia kurrë s'më ka mësuar të gënjej!

BORISI — Me kë po flet kështu, bocman, me dadon tënde?

NIKOLLAI — (*Borisit.*) Ai ka një farë të drejte të gjykojë kështu. Komunistët vërtet nuk gënjejnë. Partia nuk gënjen. (*Bocmanit.*) Por ja që gjithë bota nuk ka arritur në komunizëm, kur njerëzit do të jenë të ndërgjegjshëm e të ndershëm. Kështu që mashtrimeve të këtyre tradhëtarëve duhet t'u për-

gjigjemi me mashtrim. Ne nuk jemi kristianë të bindur që kur këta të shitur të na qëllojnë në njërën faqe, ne t'u kthejmë faqen tjetër, apo jo?

BORISI — Komandant! Ivanit rus nuk i ngjall dot urrejtjen me të tilla fjalë. Ai e do ndryshe. Jepi vodka, vëre përballë kundërshtarit dhe... davaj, zjarr!

BOCMANI — *(I indinjuar.)* Çfarë the?!

NIKOLLAI — Nuk lejoj të tilla biseda! Në këto momente na duhet unitet, a më kuptoni, unitet... *(Nikollai del në një krah. Bocmani, pasi vështron me urrejtje Borisin, del në krahun tjetër. Borisi tund zinxhirët. Hyn Skënderi.)*

BORISI — Skëndushka, për ku kështu me kaq vrull?

SKËNDERI — Po shkoj të marr konspektet e mia, se ju nuk po na jepni dokumentet e nëndetës.

BORISI — Eh, Skënder, Skënder, ku e ke atë buzëqeshjen e çiltër të Leningradit? Je ngrysur, je zvogëluar. A, harrova, je në gatishmëri. *(Qesh.)* Ushtria është një thes me budallallëqe të marra në mënyrën më serioze. Skëndushka, vazhdo të digjesh, o budist shqiptar. *(Skënderi niset të dalë, Borisi i del përpara.)* Ende nuk e ke kuptuar, mor i mjerë, se kuadrot që janë kthyer kohët e fundit nga Bashkimi Sovjetik shikohen me sy tjetër? Dhe ti nuk je viktima e vetme...

SKËNDERI — *(Rreptë.)* Po ti nga i di këto të dhëna? Mos je gjë informator?

BORISI — *(Qesh.)* Jam shoku yt i klasës, Skënder! Harrove ç'kam bërë unë për ty? E mban mend ekskursionin verën e kaluar me «Zimin» e babait nëpër gjithë Bashkimin Sovjetik? Ti kishe marrë

edhe Svetllanën me vete... Mirë mua, po Svetllanën si mund ta harrosh? Unë e di, ti e do çmendurisht atë...

SKËNDERI — *(E përfshin nga rrobat dhe e ngjesh pas një shtylle.)* Ç'pandeh ti, more zuzar! Mos jam si ti që për një femër shet edhe nënën? Shporrmu nga sytë! *(E përplas dhe largohet. Borisi mbledh veten dhe i qepet pas duke i dalë sa në një krah në tjetrin.)*

BORISI — *(Lutet.)* Skënder, vëlla! Mendo çfarë të duash për mua. Pështymë, vramë! Dëgjon? Vramë! Më është mërzitur jeta. Urrej! Të gjithë i urrej, përveç teje. Asnjë nuk shikoj dot me sy. Ty të kam të vetmin shok, dëgjon? E urrej në kulm politikën. Nikollai është qeni i politikës, por jo unë. Skëndushka... Çfarë do, çfarë do të bëj unë për ty? Më thuaj! Mjaft që ti të mos mendosh keq për mua. *(Nxjerr nga xhepi çelësat, ia hedh.)* Na, merri!

SKËNDERI — *(I pret i çuditur.)* Ç'janë këto?!

BORISI — *(I zë gojën.)* Shëttt! Mos thirr! Merrri të thashë! Janë çelësat e dokumenteve të nëndetëseve. Ki mendjen! Pakujdesia jote do të më kushtonte shtrenjt... *(Largohet me vrap. Skënderi nuk di ç'të bëjë, është edhe i shqetësuar edhe i kënaqur. Hyn Arbeni.)*

ARBENI — *(Ja shikon çelësat.)* Po këto?!

SKËNDERI — *(Buzagaz.)* Çelësat e dokumenteve.

ARBENI — *(I shqetësuar.)* Ku i gjete?

SKËNDERI — Ju e dini, pa dokumente edhe sikur të na i dorëzojnë nëndetëset, ne do të jemi si të verbër. Ata po i grisin, po i flakin në det. Duhet përfitur nga rasti, shoku Arben.

ARBENI — *(Rreptë.)* Toger Skënderi, kush jua dha çelësat?

SKËNDERI — Shoku Arben, Borisi nuk e hopen Nikollain. Borisi është miop.

ARBENI — (*Shpërthen.*) Miop je ti. Çfarë urdhri kemi nga Partia? (*Heshtje.*) Fol!

SKËNDERI — T'u shmangemi provokimeve... Borisi...

ARBENI — Përse nuk ke zbatuar urdhrin, toger Skënderi? Dhe një marinar i thjeshtë nuk do të shkiste në një gabim të tillë. Nuk e kupton se ke rënë në kurth? Ata do të japin alarmin, do të na akuzojnë si provokatorë. Ec me mua. (*Arbeni dhe Skënderi ngjitin shkallët. Nga një kajutë dalin dy marinarë dhe Kuliku.*)

MARINARI I — Nuk po duket.

MARINARI II — Si shumë u vonua.

KULIKU — Kemi urdhër të presim. (*Skënderi zbret shkallët, u shkel syrin dy marinarëve. Ata e rrethojnë*)

MARINARI I — Ja tek është.

MARINARI II — Mirëdita, shoku toger!

KULIKU — Për ku me kaq ngut, inxhinier Skënderi? E morët vesh kryeinxhinierit tonë i kanë humbur çelësat e dokumenteve të nëndetëseve. Dini gjë ju? (*Hyn Borisi.*)

BORISI — Jo kështu larg e larg... me pyetje të tilla; më praktikë. Sigurisht çelësat prehen në xhepat e tij...

(*Heshtje. I drejtohet Skënderit.*) Të vjen inat. E di, s'ke ç'i bën. Detyra mbi të gjitha. Ja, ti për shembull zien tani përbrenda dhe dëshiron të më shqyesh, por ja që nuk mundesh, detyra nuk ta lejon.

SKËNDERI — (*I papërmbajtur.*) Dëgjo këtu, o

kërmë e pispillosur, mos ndodhtë gjë se edhe prapadiellit kam për të të gjetur.

BORISI — (*Qesh me cinizëm.*) E dëgjoni çfarë thotë?! Kontrollojeni. Të më pështyni, në qoftë se ai nuk i ka çelësat në xhep. (*Skënderi e pështyn në fytyrë. Të gjithë stepen.*)

ARBENI — (*Që lart nga shkallët i hedh çelësat në këmbët e Borisit.*) Mos u fyeni, inxhinier Boris. Vetë e kërkuat. (*Të gjithë sovjetikët ulin kryet me vështrim te grumbulli i çelësave. Skënderi shikon Arbenin.*) Ne do ta ndreqim difektin edhe pa skemat tuaja!

## TABLOJA E KATËRT

(Baza lundruese është zbukuruar për festë. Në direk valavitet flamuri ynë kombëtar. Nga altoparlanti dëgjohet zëri: «Ju flet Tirana. Në orën 10 do të lidhemi me Bulevardin «Dëshmorët e Kombit» për të transmetuar manifestimin e 1 Majit».

Në skenë marinarët sovjetikë çirren dhe ulërijnë si të dalldisur duke hedhur sende në det. Rrëmuja, zhurmë. Borisi i vëren ata i kënaqur, i ulur këmbë përmbi këmbë në një karrige. Ai ndalon Vollodjan i cili matet të hedhë një arkë në det)

BORISI — Stop! (Të gjithë ndërpresin veprimet. Vollodjas) Po këtë ku e çon, pëllumbi im? Hape! (Vollodja hap arkën, duken shishet me konjak. Borisi merr një shishe) Bota njeh shtatë mrekulli, konjaku shqiptar është mrekullia e tetë! Sot është festë, pëllumbi im. Kjo nuk të falet. (Marinarët rrëmbejnë shishet. Dëgjojen brohoritjet «Rroftë 1 Maji!», «Rroftë inxhinier Borisi!», «Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni!»)

(Të geshura. Nis rrëmuja e hedhjeve të sendeve në det. Nga lart zbret shkallët Skënderi me shiritin e kuq në krah.)

BORISI — (Thërret.) Kulik! (Kuliku afrohet.) Në kajutën time kam valixhen. Shpejt këtu! (Kuliku del. Hyn bocmani dhe shikon disi i habitur rrëmujën.) Ah, bocman! (I hedh çelësat.) Më sill dokumentet e nëndetëseve. (Bocmani del kokulur. Hyn Kuliku me valixhen në dorë.) Hape! (Kuliku e hap.) Merr pakon nga e majta! (Kuliku e merr dhe e hap, nxjerr një palë këpucë.) Hidhi në det, pëllumbi im! (Kuliku i hedh në det. Të qeshura.) Pakon djathtas! (Kuliku nxjerr orë dore dhe byzylykë.) Hidhi! (Të qeshura.) Kostumin! (Kuliku nxjerr kostumin e Borisit. Borisi çohet në këmbë, i merr thikën një marinari dhe e bën kostumin rripa-rripa) Flake! (Kuliku e flak kostumin në det. Të qeshura. Ndërkohë ka hyrë bocmani me blloqet e dokumenteve në duar. Borisi pa kthyer sytë nga ai, e urdhëron.) Shkrepësen, bocman! (Bocmani nuk bën asnjë veprim.) Bocman, zjarrin dokumenteve! (Borisi shikon Skëndërin me cinizëm, Skëndëri shikon bocmanin. Bocmani shikon Borisin me urrejtje. Borisi çohet në këmbë si i çmendur.) Bocman! (Vështrohen sy ndër sy me urrejtje. Borisi rrëmben blloqet dhe i krris me histerizëm fije-fije. U vë zjarrin dhe i vërvit në det duke qeshur. Marinarët brohorasin, zhurmë, rrëmujë. Kthehen shishet. Borisi vazhdon.)

Kulik! (Kuliku afrohet.) Kulik, tregoi «Aurorës» sonë, se si duhen hedhur vjetërsirat në det. . . (Kuliku merr thesin.)

SKËNDERI — (I del përpara.) Ndal! (Tërë urrejtje) Hape thesin!.. Hape të thashë! (Ia rrëmben nga dora thesin prej nga nxjerr aparate, radio dhe kablo.) Po këto plehra janë?

KULIKU — (Me ironi.) Për ne plehra janë, për ju. . . ndoshta kanë ndonjë vlerë. (Të qeshura.)

SKËNDERI — (*Merr thesin në dorë.*) Marsh që këtej! Me ato plaçkat tuaja mund të bëni si të doni, por jo me këto. (*Shkon në paraskenë.*)

KULIKU — (*I afrohet Vllodjas.*) Po ty, nuk të pëlqen të pish me mua, ë? Po me Fatmirin? Edhe një copë byrek i qelbur i tij të shijon, mor bir bushtre! (*Kuliku e kap për fyti. Vllodja çohet. Ata përleshën. Kuliku u bën shenjë marinarëve dhe ata përfshijnë Vllodjan dhe e hedhin në det. Të qeshura.*)

BOCMANI — (*Të gjithëve.*) Turp të keni! (*Marinarët brohorasin: «Rroftë 1 Maji!», «Rroftë inxhinier Borisi!», «Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!» Nga jashtë dëgjohet: «Gatitu!» Të gjithë në panik, dalin nga skena*)

ADMIRALI SHQIPTAR — Shoku Skënder, lajmëro kapiten Arbenin të vijë këtu.

SKËNDERI — Si urdhëron!

ARBENI — (*Vjen nga lart dhe i paraqitet admiralit.*) Shoku admiral, sipas urdhrit tuaj, kapiten Arbeni paraqitet.

ADMIRALI SHQIPTAR — Afrohuni ju lutem!

ARBENI — Si urdhëron!

ADMIRALI SHQIPTAR — Ç'të reja kemi?

ARBENI — Gjendja është shumë serioze, shoku admiral. Në çdo orë, në çdo minutë, provokime nga të katër anët. Dëgjohe fyerje, sharje, kërcënime, sabotime. Ata nuk durohen më, shoku admiral. Marinarët tanë po bëjnë dyzet e tetë orë shërbim. Flenë me këpucë dhe pajime. Më parë zgjohen se sa flenë; nuk mundet më!

ADMIRALI SHQIPTAR — Çfarë, çfarë?..

ARBENI — Ata po bëhen të padurueshëm. Edhe unë nuk mundem më!



ADMIRALI SHQIPTAR — Mjaft! Mjaft, kapiten! Ç'më thoni kështu?! «Nuk mendem më»! Si nuk e kuptoni se në çfarë situatë jemi? Të fillojmë e të ankohe mi e të na hipë gjaku në kokë? Keq, shumë keq, shoku Arben! Pakujdesia më e vogël do të na bënte lodër, lodër të Traktatit të Varshavës. Dhe ti më vjen këtu e më... E di çfarë? Në vend të këtyre fjalëve do të bënit mirë të gjenit diku ndonjë qoshe për të zënë peshk.

ARBENI — Shoku admiral...

ADMIRALI SHQIPTAR — Po, po, për të zënë peshk! (Pauzë. I jep cigaren.) Ndize! (Heshtje.) Përse m'i thua të gjitha këto?! Mos vallë unë e kam më të lehtë? Mos vallë udhëheqja jonë është më pak e shqetësuar për këtë gjendje të krijuar? (Heshtje.) Të mblidhet efektivi.

ARBENI — Si urdhëron! (Bie zilja. Në skenë hyjnë shqiptarët.) Në rresht për një — mblidhu! Eja në radhë! Gatitu! (Nga shkallët zbret admiral i shqiptar.) Në qendër-ndero!

Shoku admiral...

ADMIRALI SHQIPTAR — Qetësoji!

ARBENI — Qetësohu!

ADMIRALI SHQIPTAR — (Efektivit.) Afrohuni, shokë marinarë! Uluni! Situata është shumë e rëndë, shokë. Eskadra e Detit të Zi po afrohet drejt ujërave tona. Qëllimi i tyre është të na bëjnë presion, të kthejnë bazën tonë në pikmbështetje për një kundërrivolucion. Ata përkrahen nga vendimi famëkeq i mbledhjes së marsit të Traktatit të Varshavës, që u jep dorë të lirë të bëjnë si të duan. Përballë, shokë, kemi tradhëtinë më të madhe që po pësojnë popujt. Ne jemi në vijën e parë të zjarrit. Por ne pranojmë më mirë të vdesim me nder

për Atëdhenë tonë socialist, se sa të rrojmë të gju-njëzuar. Prandaj partia ju drejtohet juve, bijve të saj, që keni kryer me nder afatin e shërbimit, dhe ju bën thirrje të qëndroni ende në postet tuaja luftarake në këto momente, kur fatet e Atdeut janë në rrezik. (*Të gjithë marinarët thërrasin njëzëri.*) I shërbejmë Republikës Popullore të Shqipërisë.

ARBENI — Nëpër detyra, shokë!

(*Efektivi del nën komandën e Skënderit. Në skenë mbeten admiralitë shqiptar dhe Arbeni.*)

ADMIRALI SHQIPTAR — Delegacionit sovjetik, që ka ardhur këtu, nuk i ndezi me bisedime në Tiranë. Vullkovin e thirrën urgjent në ambasadë. Pak më përpara fola me qendrën. Asnjë provokim nga ana jonë. Në të gjithë vendin është vendosur gatishmëria luftarake. Çdo gjë mund të ndodhë, prandaj kujdes! Hapni sytë, forconi vrojtimin, dyfishoni rojet! Mirë u pafshim!

ARBENI — Si urdhëron! (*Admirali ngjitet shkallët, Arbeni bën të dalë. Përpara i del Nikollai.*)

NIKOLLAI — (*Ironik.*) Sonte është 1 Maji, koleg. Dita e solidaritetit ndërkombëtar, ndërsa ju po i ushqeni vartësit me demagogji dhe urrejtje për Bashkimin Sovjetik, po kultivoni shpirtin e ngushtë nacionalist, koleg...

ARBENI — Ne do ta forcojmë ende këtë lloj «nacionalizmi»...

NIKOLLAI — E pranoni këtë me gojën tuaj?

ARBENI — Po. Kush nuk lufton për diktaturën e proletariatit në vendin e vet, ai e ka varrosur internacionalizmin proletar.

NIKOLLAI — (*Buzëqesh me ironi.*) Diktaturë... Diktaturë... Atje ku ndërtohet komunizmi, kjo fjalë

u përket barbarizmave. Në komunizëm njerëzit luf-  
tojnë për një qëllim. Në komunizëm. . .

ARBENI — (*E ndërpret.*) Në komunizëm ama. . .

NIKOLLAI — Si? Edhe këtë kërkonti ta mohoni?! Tashmë te ne nuk gjen më shtypës e të shtypur. Ne kemi një unitet mendimi e veprimi. Te ne, të gjithë janë vëllezër të një klase. . . (*Dëgjohet zëri i Borisit.*): «Tishe!» (*Hyn Borisi dhe bocmani.*) Pra, desha të them, te ne të gjithë janë vëllezër të një klase. . .

BORISI — (*Shpërthen.*) Ky injorant, të më thotë mua huligan?!

BOCMANI — (*I vrarë shpirtërisht.*) Po, po, ti je huligan i vërtetë.

BORISI — Preji fjalët!

NIKOLLAI — Boris! (*I fut krahun për ta qetësuar. Shikon Arbenin i zënë ngushtë.*)

ARBENI — (*I qetë.*) Ju kuptova, kapiten. . . «Vëllezër të një klase.» (*Arbeni del.*)

NIKOLLAI — (*Bocmanit.*) Do ta shohim punën tënde, bocman. Marsh në detyrë! (*Nikollai del me Borisin. Bocmani qëndron i vrarë shpirtërisht, duke parë i hutuar një skuadër marinarësh shqiptarë të armatosur me Agimin në krye, që zbret me shpejtësi te nëndetëset. Katër-pesë marinarë të tjerë shqiptarë ulen në një qoshe të kuvertës dhe nisin të qërojnë patate.*)

BOCMANI — (*Me vete.*) Ç'po ndodh kështu vallë?! Dy komunistë po hamë të gjallë njëri-tjetrin. Jo, Borisi nuk është komunist, ai është huligan! (*Me dhembje.*) Mos po krimbet partia kështu?! Mos po krimbet kështu partia! Borisi komunist? (*Shpërthen.*) Ai është huligan! (*Me dhembje.*) Po përse të ndodhë kështu vallë? Përse?! (*Vjen nga nëndetëset Agimi.*) Agim!

AGIMI — !..

BOCMANI — Dua të të pyes për diçka...

AGIMI — Nuk është nevoja.

BOCMANI — Dëgjo, mor bir, të flas me zemër të hapur.

AGIMI — U ngopëm me singeritetin tuaj. (Heshtje.)

BOCMANI — Përse është grindur partia juaj me tonën?

AGIMI — Nuk e di.

BOCMANI — Në kongresin tuaj ju folët me dashuri të madhe për ne. Këto i dëgjova me veshët e mi. Atëherë mos keni bërë ndonjë seancë të mbyllur dhe...

AGIMI — Seancat e mbyllura bëhen nëpër gjyqe, bocman, dhe, në të kujtohet, në kongresin tuaj XX. (Heshtje e gjatë.)

BOCMANI — Kam kohë që diç po më ther këtu. (Fërkon gjoksin.) Dua të bisedoj me dikë, t'i flas hapur çfarë më ndjen shpirti... Unë jam bolshevik i vjetër. A e di ç'do të thotë të të lëkundet besimi të partia, te ajo që i ke kushtuar gjithë jetën?

AGIMI — Unë nuk jam kishë për t'u rrëfyer, bocman.

BOCMANI — Çfarë?! Ti nuk më beson mua? (I afrohet me dhembje.) Ç'kërkon ti që të më besosh, more bir? Ja tek po të them, në organizatën tonë bazë u punua një letër, që partinë tuaj e quan tradhëtare, dogmatike. Aty na porositën të bëjmë çmos që ju të largoheni këtej dhe kjo bazë të mбетet krejt sovjetike, ose përndryshe ne do t'i tërheqim të gjitha nëndetëset për në Bashkimin Sovjetik. A të mjaftojnë këto? Po të tregoj sekretet e partisë! (I menduar.) Më dhanë urdhër të heq nga kajuta ime

fotografinë e Stalinit, ta grisja dhe ta flakja në det. Jo! Unë nuk e hodha, por e kam fshehur, a më dëgjon, e kam fshehur... (Me dhembje.) Agim... (Agimi e shikon drejt në sy.) Oh, sa i ngjet Olegut tim, more bir... Ende nuk më beson? (Shpërthen.) Po besomë, ta marrë djalli! (Ul kokën me dhembje. Agimi afrohet ta qetësojë.)

AGIMI — Bocman, ti... (Ndërkohë hyn Borisi. Agimi sapo e sheh ndryshon tonin e të folurit.) Bocman, ti s'je gjë tjetër veçse një provokator i ndyrë.

BOCMANI — (Që nuk ka parë se ka hyrë Borisi.) Kush, unë?!

AGIMI — (Rrotullohet në mënyrë që bocmani ta shikojë eprorin.) Po, po, ti... Ti përfiton nga rasti që punojmë së bashku dhe më bën agjitacion që të mos e rregullojmë difektin e nëndetëses. Çfarë është kjo? (Borisit.) Ju lutem shumë, inxhinier Borisi, në qoftë se bocmani ka ardhur për të më ndihmuar, të mbajë vendin që i takon, përndryshe... (Tregon rrugën me dorë. Borisi i afrohet Agimit. E heton. I afrohet dhe bocmanit, e heton, pastaj me buzëqeshje cinike flet gjithë dyshim.)

BORISI — Bocmani kështu?! Interesant... Mirë pra, le të bëhet ashtu siç thotë Agimi. (Borisi i bën shenjë bocmanit të largohet. Bocmani del kokulur. Borisi vështron Agimin, i cili kthen kurrizin dhe ngjitet shkallët të çelë radion.)

FATMIRI — Ç'pate me bocmanin? Edhe bocmani!

AGIMI — Lëre këtë muhabet, Fatmir.

FATMIRI — Po sikur ta bëjnë si englezi në dyzetekatrën, bre Agim?

AGIMI — Atëherë dy duar për një kokë.

FATMIRI — Më vjen keq për Vullodjan.

AGIMI — Hë, more, se dhe Vullodja yt është një kokërr indiferenti që s'e ka shokun.

FATMIRI — Shokut i thotë shok ai, dhe jo go-rrica.

AGIMI — Mos ardh të puna te këmbëza e pushkës, se ai Vullodja yt, ty do të të vrasë të parin.

FATMIRI — Kjo nuk më besohet.

AGIMI — Ai do të zbatojë urdhrin e shefave, ndryshe e paguan me kokën e tij. (*Lëviz çelësin, hap radion.*)

FATMIRI — Po përse nuk shporren atëherë?

(*Dëgjohet zëri i spikerit të radios.*) «Ju flet Tirana! Po lidhemi me bulevardin «Dëshmorët e Kombit» për të transmetuar manifestimin e punonjësve, për nder të 1 Majit.» Dëgjohen brohoritje dhe atmosfera e 1 Majit. Ndërkohë Borisi i ka bërë shenjë Kulikut dhe tre-katër marinarëve të tjerë sovjetikë për të dalë. Ndërpritet transmentimi. Agimi i shqetësuar tund radion. Kuliku me shokë qeshin me Agimin. Njëri prej tyre ka këputur fillin e altoparlantit dhe herë e takon e herë e stakon duke i bërë shokët e vet të qeshin. Kuliku i afrohet direkt të flamurit tonë. Matet ta këputë litarin me thikë. Agimi i shqetësuar vërvitet nga shkallët dhe e pret flamurin tonë në duar, pa e lënë të bjerë në shesh duke e qëlluar me grusht Kulikun. Me të shpejtë vij në marinarët shqiptarë që qëronin patate, të cilët bëhen bllok në formë rrethi për qark direkt të flamurit. Dëgjohen ulërime të shtumura).

KULIKU — E hej, shqiptarët filluan provokimet!

MARINARË SOVJETIKË — (*Duke dalë me vrap.*) E hej provokaci! (Zëra nga jashtë: E heej, e heej, albanski naçali provokaci.) (*Kuliku vërsulet*

drejt Agimit, por prapset kur shikon shokët e tij me thika ndër duar. Agimi nis të lidhë flamurin te direku. Në kuvertë dynden dhjetëra marinarë sovjetikë që ulërijnë si çakej. Disa kërcënojnë me grushta, disa vringëllijnë thikat, disa fishkëllejnë me gjes-te të pahijshme duke u çjerrë rreth e qark direkt, përballë marinarëve tanë që qëndrojnë kala në mbrojtje të flamurit. Dëgjohen kërcënimet e sovjetikëve:

— Tradhëtarë!

— Sot është 1 Maji, duhet ngritur flamuri me drapër e çekan.

— Të kujt i keni rrobët.

— Edhe armët, që mbani, tonat janë!

— Edhe nëndetëset janë tona!

— Të gjitha ne jua kemi dhënë!

— Ju nuk keni asgjë.

— I keni ditët të numëruara.

— Si krimbat do të ngordhni!

Tashmë kanë vërshuar edhe marinarët shqiptarë. Janë krijuar dy blloqe përballë njëri-tjetrit. Tensionimi ka arritur kulmin. Janë gati të përleshën. Kuliku del përpara shokëve të vet. U afrohet shqiptarëve.)

KULIKU — (Me kërcënim.) Partia juaj është e shitur, partia juaj është shitur për tri aspra. (Ai nuk arrin ta mbarojë fjalën se Agimi i është afruar. Kuliku ngre dorën për ta qëlluar me thikë. Agimi i shtrëngon dorën duke ia drejtuar majën e thikës drejt gjoksit.)

AGIMI — Partinë tonë e duan edhe gurët, mor qelbanik!

(Hyn Arbëni i alarmuar.)

ARBËNI — Agim!

AGIMI — (*Lëshon dorën e Kulikut, merr drejt-qëndrim para eprorit. Kuliku matet ta qëllojë pas shpine, por thika i ngelet në ajër se Arbeni e ka shmangur Agimin. Hyn Nikollai.*)

NIKOLLAI — Kulik (*U bërtet të tijve*) Llafazanë! Po bini viktima të provokacioneve të këtyre. Marsh! Marsh nëpër detyra! (*Arbenit.*) Ç'janë këto aventura, shoku Arben? Ne protestojmë energjikisht për provokimet tuaja. Në mënyrë banditeske, ju deshët të përvetësonit çelësat e dokumenteve. Ju keni krijuar një gjendje tensioni të padurueshëm në marrëdhëniet tona. Ju po bëheni përçarës. Si mund të jetoni ju pa Bashkimin Sovjetik? Ju jeni të rrethuar nga të katër anët.

ARBENI — Eskadra e Detit të Zi, që po vërtitet rreth ujërave tona, mos ka ardhur të na shpëtojë nga rrethimi?

NIKOLLAI — (*I zënë ngushtë.*) Ju gaboheni, kapiten. Ajo është flota e gjashtë amerikane.

ARBENI — (*Rreptë.*) E verifikuam. Vërtet flotës së gjashtë i ngjan... (*Agimi lidh fillin e altoparlantit. Dëgjohet atmosfera e 1 Majit.*)

NIKOLLAI — Me ç'të drejtë ju kontrolloni pa dijeninë tonë?!

ARBENI — Me të drejtën e një populli të armatosur, që bën ligjin e këtij vendi. (*Atmosfera e 1 Majit buçet nga altoparlantët.*)



## EPILOGU

(Mesnatë. Fatmiri dhe Vullodja kryejnë detyrën e rojes. Vetëtima, bubullima.)

VOLLODJA — U prish koha... Fatmir, a të thashë se do të priset koha?

FATMIRI — ...

VOLLODJA — Të kanë porositur të mos bësh muhabet me mua, ë?... Epo mirë, mos fol. Edhe mua më thanë ta prish shoqërinë me ty. Po ne jemi miq e shokë, vëllaçko, dhe pikë.

FATMIRI — Lëri fjalët, Vullodja. Ty, po të të urdhërojnë, më drejton pushkën mua, ndryshe e paguan me kokën tënde.

VOLLODJA — Pse, ti më vret mua?

FATMIRI — Të vras që ç'ke me të.

VOLLODJA — (I shqetësuar.) Të kam thënë. mos me politikë. Politika është bushtër.

FATMIRI — Nuk ka politikë më të qelbur se këto llafet e tua...

(Vetëtima, bubullima.)

VOLLODJA — Eh, u prish... u prish koha!  
(Hyn Arbeni.)

FATMIRI — Ndal!

VOLLODJA — Stoj!

ARBENI — Jam komandant Arbeni. (*Afrohet dhe merr Fatmirin mënjanë.*) Fatmir, çdo gjë mund të përitet prej tyre. Ki kujdes!

FATMIRI — Si urdhëron, shoku komandant!

ARBENI — (*Me zë të lartë.*) Pra ti, Fatmir, ke frikën e çakostimit të nëndetëseve nga era e madhe. ë? (*Hyn Nikollai.*)

VOLLODJA — Stoj!

FATMIRI — Ndal!

NIKOLLAI — Komandant Nikollai (*Afrohet.*) A, edhe ju, shoku Arben, jeni shqetësuar nga furtuna që po afrohet? (*Vëren nga deti.*) Sipërfaqja nuk të jep përshtypjen e valëzimit. Me sa duket do të ketë det të vdekur!

ARBENI — Edhe më keq... Deti i vdekur zien përbrenda si puna e ujit nën rrogos... (*Nisen për të datë. Nikollai bën sikur ka harruar diçka. I afrohet Vollodjas.*)

NIKOLLAI — Vollodja, qysh nga ky çast të mos lejosh asnjë shqiptar të nëndetëset.

VOLLODJA — As komandant Arbenin?

NIKOLLAI — As edhe një. Qartë?

VOLLODJA — Qartë!

NIKOLLAI — Zbato urdhrin!

VOLLODJA — (*Merr drejtqëndrim.*) Si urdhëron! (*Nikollai afrohet tek Arbeni.*)

NIKOLLAI — Rojet duhen kontrolluar herë pas here, shoku Arben. Ndryshe humbet vigjilenca...

ARBENI — Për këtë keni të drejtë. (*Bubullima, vetëtima.*)

NIKOLLAI — E kam vënë re shpesh. Te ju prishet koha, kur nxihet qielli nga ana e detit.

ARBENI — Nga deti na kanë ardhur shumë të këqija...

NIKOLLAI — Pak më qartë, ju lutem!

ARBENI — Desha të them, shpeshherë, edhe armiqhtë nga deti na kanë ardhur... Italianët, anglezët dhe tradhëtarët e ndryshëm të çdo kallëpi...

NIKOLLAI — (*Shikon qiellin.*) Interesant, ju keni një qiell të errët dhe të zi si nata...

ARBENI — Gaboheni! Ju nuk e njihni qiellin tonë. Retë e zeza mblidhen e mblidhen e bëhen kattran këtu në breg të detit, po, sapo përplasen me malet tona, çahen e nuk u mbetet nam e nishan. Pas kësaj, qielli ynë bëhet i kaltër dhe i bukur siqelqi...

NIKOLLAI — Po përdorni alegori, koleg. Po ju jeni komunist! Si nuk e kuptoni që partia juaj nuk mund të ekzistojë pa partinë mëmë të Bashkimit Sovjetik? Sa muaj, sa ditë, sa orë mund të mbajë ajo mbi shpinë fatet e revolucionit?

ARBENI — (*I prerë.*) Revolucioni nuk eksportohet si qilimat e kapiten Nikollait... (*Dalin nga e kundërta e njëri-tjetrit. Fatmiri e Vullodja heshitin për një kohë të gjatë.*)

FATMIRI — Pse t'u kyç goja? Fol!

VOLLODJA — ...

FATMIRI — Çfarë të tha komandanti?

VOLLODJA — Fatmir, djalli i merr vesh këto punë. (*Me sinqeritet.*) Po ne të dy jemi miq e sho-kë, vëllaçko, dhe pikë.

FATMIRI — Çfarë të tha komandanti? (*Vetëtim, bubullima, shi.*)

VOLLODJA — Eh, ç'u prish kjo kohë, që ishte aq e mirë! Si nuk po kalon fare ora e këtij shërbi-mi të mallëkuar?... (*Hyn Nikollai.*)

FATMIRI — Ndal!

VOLLODJA — Stoj!

NIKOLLAI — Jam komandant Nikollai. (*Hyjnë*)

pas tij Borisi dhe disa marinarë sovjetikë. Fryn erë. I drejtohet Borisit.) Boris, kjo erë e madhe mund të çakostojë nëndetëset. Duhet marrë masa. (U bën shenjë marinarëve.) Shpejt, djem! (Nikollai, Borisi dhe marinarët shkojnë te nëndetëset.)

FATMIRI — (Vollodjas.) Pse hynë te nëndetëset ata? Fol, ç'kërkojnë ata atje?

VOLLODJA — Fatmir, djalli e merr vesh... Unë...

FATMIRI — I poshtë, prandaj e kyçe gojën ti?! (Fatmiri bën shenjë duke rrotulluar krahu energjikisht me kapelën e tij në dorë. Dëgjohet zhurmë motorësh. Fatmiri fishkëllen i shqetësuar. Zhurma sa vjen e rritet. Hyn me vrap Arbeni.)

VOLLODJA — Stoj. (Arbeni ndalon.)

ARBENI — Jam komandant Arbeni, more!

VOLLODJA — Kam urdhër të mos lejoj asnjë, shoku komandant.

FATMIRI — (I afrohet Vollodjas i egërsuar.) Edhe këtë e bëre, mor zagat!

(Sapo Vollodja kthen kokën nga Fatmiri, Arbeni vërtitet me shpejtësi brenda në nëndetëse.)

VOLLODJA — (Bërtet.) Unë kam urdhër, dëgjoni! Stoj! Stoj!..

FATMIRI — Të thashë, mor zagat, të thashë, se do të më drejtoje pushkën!..

(Vollodja e ul armën me turp. Bie sinjali rrëqethës i alarmit.)

VOLLODJA — (I shqetësuar.) Po tani? Unë jam ushtar. A e di se ç'mund të ndodhë me mua tani! Stoj!

FATMIRI — Mos u tremb nga kjo sirenë! Ajo po të zgjon nga gjumi.

(Hyjnë me vrap marinarë shqiptarë dhe Fatmiri futet tog me ta te nëndetëset. Hyjnë i alarmuar Nikollai dhe Borisi. Nikollai e qëllon në fytyrë Vollodjan.)

NIKOLLAI — *(Me egërsi.)* Idiot! *(Borisit.)* Merrri armën, fute në arrest. Në arrest! Në litar!

*(Nga jashtë vijnë të shqetësuar dhe gjithë hutim marinarë të tjerë sovjetikë dhe bocmani. Nga nëndetëset del Arbeni.)*

NIKOLLAI — *(Me kërcënim.)* Ç'do të thotë kjo, kapiten? Ju hyni në nëndetëset tona si në shtëpinë tuaj...

ARBENI — *(I qetë.)* Po mbushen disa vjet që në këto anije valon flamuri shqiptar. Dhe ju e dini mirë këtë.

NIKOLLAI — Rregullorja njeh vetëm një komandant. Vetëm një. Kush duhet të komandojë këtu, ti apo unë!

ARBENI — Këto mjete janë pjesë e kësaj toke dhe kjo tokë nuk ka pranuar kurrë ta komandojnë të huaj...

NIKOLLAI — Mjetet janë ende në duart tona, kapiten. Dhe këtu komandoj vetëm unë! Qartë?

ARBENI — Komandanti te mjeti i tij nuk hyn si hajdut në mes të natës, herr kapiten!..

NIKOLLAI — *(I fyer shikon marinarët e tij dhe bocmanin.)* E dëgjuat. A e dëgjove, bocman? Ti je komunist. Më tha «herr kapiten» ose oficer i gestapos mua, oficerit sovjetik. Ushtrinë e kuqe, ndosh-ta, kërkon ta quajë ushtri fashiste? Sllushatje maju komandu. «Vsjeh vniz!»

*(Marinarët sovjetikë zbresin poshtë.)*

ARBENI — *(Ekipazhit shqiptar që ndodhet poshtë.)* Mbahuni, djem! Secili në pozicionin e vet.

NIKOLLAI — Podvodnuju llodku ekstreno kvihodu prigatovit!

ARBENI — Komanda, nëndetëse urgjent për lundrim përgatit, prapsohu! Mos luani nga pozicionet, shokë!

NIKOLLAI — (*Me mburrje*) Ushtria e Kuqe gjithmonë u ka dhënë mësim të mirë luftënxitësve.

ARBENI — Qëndroni, vëllezër! Ata na akuzojnë për luftënxitës, sepse ne nuk puthemi me imperialistët!

NIKOLLAI — (*Me kërcënim.*) Do ta shikojmë kokëfortësinë tuaj!

ARBENI — Na quajnë kokëfortë se nuk i shesim fitoret e revolucionit.

NIKOLLAI — Ju jeni tradhëtarë...

ARBENI — Krenohuni, shokë, që na quajnë tradhëtarë, këta tradhëtarë të marksizëm-leninizmit!

NIKOLLAI — (*Si i tërbuar.*) Podvodnuju llodku ekstreno kvihodu prigatovit!

ARBENI — Komanda, për lundrim përgatit, prapsohu!

NIKOLLAI — Kvihodu, prigatovit!

ARBENI — Prapsohu!

NIKOLLAI — Prigatovit!

(*Dëgjohet zhurmë motorësh.*)

ARBENI — (*I shqetësuar.*) Komanda, për lundrim përgatit, prapsohu! Prapsohu, komanda për lundrim përgatit. A dëgjoni, more shokë! Fikni motorët! Prapa kemi një popull në këmbë. Ata, sytë e zemrën këtej nga ne i kanë. Mos lejoni asnjë veprim. Atdhe a vdekje! Po të përulemi ne, tradhëtia e tyre do bëjë kërdrinë. Do të mashtrojnë popujt. Nuk i përkasim më vetes, shokë! Qëndresa jonë është sinjali që u japim popujve të botës për të njohur tradhëtarët më të mëdhenj të kohërave...

NIKOLLAI — (*Qesh me cinizëm.*) Ushtria e Kuqe ka tronditur botën, kapiten...

ARBENI — (*Me vendosmëri.*) Dëgjoni urdhrin tim, shokë! Vini re! Komanda, nëndetëse për lun-

drim përgatit, prapsoku! *(Nikollai qesh me cinizëm. Arbeni pret me ankth. Pauzë. Pas pak humbet zhurma e motorëve. Nikollai ndërpret të qeshurën. Arbeni fshin djersën e ballit.)*

NIKOLLAI — Shto slluçillas?!

ARBENI — *(I lumtur.)* Ja, kështu, vëllezër! Ju lumtë, trima!

*(Agon, qielli bëhet i kuq.)*

NIKOLLAI — *(I tronditur.)* Çfarë ndodhi?! Qetësi apo më bëjnë veshët... *(Kapet pas një hekuri dhe çirret)* Jo, nuk është e mundur! *(Del me vrull nga nëndetëset Borisi duke thirrur i alarmuar.)*

BORISI — Marinarët tanë janë derra! Ata janë anarshistë! Disa nuk i zbatojnë urdhrat fare...

NIKOLLAI — *(Borisit me inat.)* Disfatist! *(I afrohet Borisit.)* Ti do plumbin ballit! Marinarët tanë janë të pathyeshëm. *(Ndërkohë hyn admirali shqiptar dhe me vendosmëri, i qetë, burrëror, i drejtohet Nikollait.)*

ADMIRALI SHQIPTAR — Ne e prisnim rezultatin e logjikës suaj, por, ju nuk e prisnit një fund të tillë...

NIKOLLAI — Shoku admiral!

ADMIRALI SHQIPTAR — Dorëzoni nëndetëset!

NIKOLLAI — Kjo është sjellje brutale? Ne... në fund të fundit kemi eprorët tanë dhe ju nuk keni të drejtë të...

ARBENI — *(Nikollait)* Dokumentet ju i grisët, kështu që bashkë s'na mbetet asnjë formalitet... Ja rruga. *(Bën me dorë.)*

NIKOLLAI — *(Nuk di ç'të bëjë. I egërsuar u drejtohet të gjithëve.)* Dëgjoni! Varshava... Traktati i Varshavës do ta zgjidhë qëndrimin tuaj. Jasno? *(Nikollai nis të pari kokulur, si një rob lufte. Pas i vjen Borisi dhe kështu me radhë dalin nga*

nëndetëset një për një të gjithë sovjetikët. Ata zbre-  
sin të gjithë me kurrizin nga spektatorët. Secili ka  
një vështrim më vete. Marinarët sovjetikë reagojnë  
në mënyra të ndryshme. Nga nëndetëset del edhe  
Vollodja. I ngul shikimin Fatmirit, por një marinar  
e shtyn atë me forcë dhe e kërcënon.)

KULIKU — (Vollodjas.) Sukij sin' A nu ka, ubi-  
rajsa ot su da! (Vollodja sa nuk rrëzohet nga e shtyra  
e shokut, kthen kokën me dhembje nga Fatmiri dhe  
largohet. I fundit kalon bocmani i dërmuar shpirtë-  
risht. Ai i shikon shqiptarët me mirënjohje. I afro-  
het Agimit.)

BOCMANI — (I menduar.) Turpin e shtëpisë si-  
me nuk e tret as dheu. . . Na duhet të mbajmë mbi  
shpatulla një përleshje tjetër. Po, duhet luftuar.  
Rrugë tjetër nuk ka. Mësimin ma dhatë ju, bijtë e  
mi... (Del kokulur. Dëgjohen kërcënime, të shara,  
ulërime që sa vijnë e largohen. Të gjithë të pranish-  
mit, hedhin vështrimin nga admiralit shqiptar.)

ADMIRALI SHQIPTAR — Shokë marinarë dhe  
oficerë trima! Në emër të Partisë dhe të Komandan-  
tit Suprem, ju përgëzoj për heroizmin tuaj!. Kjo ve-  
për e shkëlqyer dhe heroike, kjo fitore, nuk do të  
jetë vetëm e juaja, dua të them, nuk do të mbetet  
vetëm midis nesh, mes popullit tonë... Jehona e saj  
e lavdishme do të shtrihet edhe përtej kufijve të  
Atdheut tonë, duke u shndërruar kështu në një bu-  
rim të pashtershëm frymëzimi, në një shembull tri-  
mërie të lartë për kohërat dhe brezat e ardhshëm.  
Do të kalojnë vite dhe komunistët e popujt e botës,  
do të ngrihen në përleshje edhe më të ashpra kun-  
dër kësaj tradhëtie të madhe. Por gjithmonë ata do  
ta kujtojnë me respekt e mirënjohje sinjalin e kuq  
të Partisë sonë, kushtimin e Enver Hoxhës.